



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tiranë, institucionet e saj të**  
**varësisë dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**Auditim Tematik i Përputhshmërisë**  
***“Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës”***

**Tiranë, korrik 2025**

# PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE: .....	4
1. Përshkrim i shkurtër i auditimit. ....	4
2. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve. ....	6
3. Konkluzioni i auditimit. ....	8
II. HYRJA .....	10
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit. ....	10
2. Identifikimi i çështjes. ....	10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim. ....	11
4. Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:.....	11
5. Kriteret e vlerësimit. ....	12
6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. ....	12
7. Metodatat e auditimit. ....	12
8. Dokumentimi i auditimit.....	13
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT .....	13
1. Informacioni i përgjithshëm:.....	13
2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit: .....	14
2.1. Mbi shkakun e ndotjes në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe vlerësimin mjedisor .....	14
2.2. Masat parandaluese të marra për mbrojtjen mjedisore të basenit të Liqenit Artificial të Tiranës. .....	19
2.3 Mbi masat e marra për përmirësimin e situatës së shfaqur në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe menaxhimi i qëndrueshëm. ....	26
IV. REKOMANDIME: .....	35

## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>EUROSAI</b>	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>PMLAT</b>	Parku i Madh i Liqenit Artificial të Tiranës
<b>LAT</b>	Liqeni Artificial i Tiranës
<b>APR</b>	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
<b>FSHN</b>	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>UKT</b>	Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a
<b>DPN2</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik
<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>ARM</b>	Agjencia Rajonale e Mjedisit
<b>AKUK</b>	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve
<b>IKMT</b>	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
<b>NJVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>PKMM</b>	Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit
<b>SNA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFPP</b>	INTOSAI Framework of Professional Pronouncement.
<b>CEMSA</b>	Consolidation of the Environmental Monitoring System in Albania
<b>RP</b>	Raport Prova

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:**

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Programit të Auditimit nr. 1350/1, datë 12.12.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) kreu auditimin tematik të përputhshmërisë në Bashkinë Tiranë dhe institucionet e saj të varësisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës.

Ky auditim tematik u iniciua bazuar në shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1323 prot, datë 04.11.2024, ku parashtrohet shqetësimi publik mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës, në të cilin janë zhvilluar disa alga me ngjyrë të gjelbër dhe të verdhë duke mbuluar sipërfaqe të konsiderueshme dhe që emetojnë në ajër një aromë të pakëndshme dhe shqetësuese për qytetarët që frekuentojnë Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës (PMLAT).

### **1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

#### **a. Përshkrim i çështjes**

Auditimi kishte si objekt vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse për problematikën e evidentuar mbi ndotjen ujore dhe dëmtimin e botës së gjallë, në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe mbuloi periudhën e viteve 2021-2024.

Liqeni Artificial i Tiranës është një prej atraksioneve kryesore të qytetit. Ai u ndërtua në vitin 1950 si pjesë e një projekti të madh për zhvillimin e qytetit. Fillimisht, ky liqen kishte si qëllim të shërbente për kontrollin e ujërave të shiut dhe për mbrojtjen e qytetit nga përmbytjet. Gjatë viteve ai u transformua në një zonë rekreative, ku mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme. Njëkohësisht, ai është një hapësirë e rëndësishme ekologjike. Me kalimin e viteve, Liqeni Artificial ka fituar një rëndësi të madhe në jetën sociale dhe kulturore të Tiranës.

Sa i përket ndotjes së Liqenit Artificial të Tiranës, eksperti i fushës (i angazhuar si pjesë e grupit të auditimit) prof. B. B., shprehet se: *“Gjatë vrotimit të liqenit, është vënë re një popullatë shumë e madhe e shpendëve, që tregon se në liqen shpendët kanë gjetur ushqim të bollshëm (biomasë e bollshme). Përmbajtja e rritur e nutrientëve (fosfateve etj.) si dhe saturimi i vogël me oksigjen, tregon se ky liqen është në gjendje eutrofike (“I sëmurë”). Përkeqësimi i kësaj gjendje do e bëjë të pamundur jetesën e gjallesave në këtë trup ujor. Dukuria e ngordhjes së peshqve në mënyrë masive, dalja e tyre në sipërfaqe për shkak të mungesës së oksigjenit e konfirmon gjendjen e degraduar dhe praninë masive të shpendëve. Përmbajtja e lartë e nutrientëve dhe e ulët e oksigjenit tregon se në liqen ka derdhje të shumta, qoftë të substancave të pasura me azot dhe fosfor, qoftë edhe të substancave reduktuese, të cilat konsumojnë oksigjenin. Gjithashtu, kur ka një akumulim të biomasës (bimësisë), pas “vdekjes” së bimëve ose algave, fillon procesi i dekompozimit, i cili kërkon oksigjen dhe çon në një ulje të përmbajtjes së oksigjenit të tretur në ujë, veçanërisht në orët e errësirës, kur fotosinteza ndalon dhe ndodh respiracioni. Kjo e bën ekuilibrin e oksigjenit një faktor delikat të cilin duhet ta monitorojmë në liqen”.*

**Foto 1-4:** Pamje nga shtresa e krijuar në Liqenin Artificial të Tiranës



**Burimi:** Burime të hapura (media)<sup>1</sup>



**Burimi:** Burime të hapura (media)<sup>2</sup>



**Burimi:** Burime të hapura (media)<sup>3</sup>



**Burimi:** Foto nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit

Në kuadër të situatës së shfaqur në sipërfaqen e liqenit, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (APR), si institucioni i varësisë së Bashkisë Tiranë, që ka nën administrim Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, ka iniciuar korrespondenca me institucione të qeverisjes qendrore dhe lokale, duke kërkuar informacion dhe marrjen e masave si më poshtë:

1. APR-ja i është drejtuar Fakultetit të Shkencave të Natyrës, për situatën e krijuar në ujërat e Liqenit Artificial të Tiranës dhe sipas relacionit të këtyre të fundit, kjo dukuri vjen si pasojë e shkarkimit në këtë liqen të ujërave të pa trajtuara. Në përgjigjen e prof. A. M. citohet në mënyrë të përmbledhur se: “Nga vëzhgimi arrihem në përfundimin, se bëhet fjale për lulëzim të Cianobakterit *Microcystis Aeruginosa*... Theksojmë se kjo dukuri (ky lulëzim algash) në Liqenin Artificial të Tiranës është pasojë dhe sinjal i ngarkesës relativisht të lartë të ndotjes...”.
2. APR-ja i është drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, duke kërkuar ndërmarrjen e një inspektimi mbi situatën. AMBU-ja konfirmon gatishmërinë për bashkëpunim dhe vlerëson që në këtë proces do të duhet të përfshihet dhe AKM.
3. APR-ja ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (i) kryerjen e inspektimeve të subjekteve tregtare që operojnë brenda PMLAT dhe (ii) marrjen e mostrave dhe analizimin e shtatë pikave të identifikuara prej saj si mundësi ndotjeje për Liqenin Artificial të Tiranës, sipas vendndodhjeve. Në përgjigje të kësaj AKM ka kryer analiza, ku sipas raporteve të analizave mbi cilësinë e ujit të Liqenit Artificial të Tiranës, ka rezultuar përmbajtje mbi normë e fosforit dhe nitrateve si dhe nevojës kimike për oksigjen, që është tregues i shkarkimeve të ujërave të patrajuara urbane në liqen.
4. APR-ja ka kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) informacion të detajuar nëse subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të

<sup>1</sup> <https://www.reporter.al/2024/10/14/ujerat-e-liqenit-artificial-te-tiranes-ndoten-me-cianobaktere-helmuese/>

<sup>2</sup> <https://joq-albania.com/artikull/1270159.html>

<sup>3</sup> <https://www.reporter.al/2024/10/30/agjencia-e-mjedisit-thote-se-te-liqeni-artificial-nuk-ka-ndotje/>

PMLAT shkarkojnë ujëra të patrajtuara në ujërat e Liqenit të Tiranës. Nga AKUK nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje.

**5.** APR-ja ka kërkuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kryerjen e inspektimit të plotë dhe marrjen e masave të nevojshme, në lidhje me subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike, nëse shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajtuar në ujërat e Liqenit Artificial të Tiranës”. IKMT ka angazhuar inspektorët në terren, të cilët kanë konstatuar 8 pika aktive ku kryhej shkarkimi i ujërave në liqen. Këto pika ishin kryesisht dalje të kanalizimeve të ujërave të bardha që vijnë nga kolektorët për mbledhjen e ujërave sipërfaqësore të rrugës (autostrada Unaza e Madhe). Nga inspektorët bëhet me dije se u rakordua që nga ana e APR-së të kërkohej pranë UKT-së prania e specialistëve, si dhe hartat përkatëse me kanalizimet të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në shkarkimet sipërfaqësore të Liqenit. Kryeinspektori i IKMT-së i drejtohet UKT-së duke kërkuar marrjen e masave të menjëhershme për diferencimin e ujërave të bardha nga ato të ndotura, si dhe mbylljen/ izolimin e pikave që shkarkojnë ujëra të ndotura.

**6.** APR-ja ka kërkuar nga Ujësjetës Kanalizime Tiranë (UKT sh.a) bashkëpunim për kryerjen e inspektimit të rrjetit të shkarkimit të ujërave të ndotura, që mund të rrjedhin në të gjithë zonën e Parkut të Madh të Liqenit të Tiranës, për të siguruar nëse ka rrjedhje të ujërave të ndotura të patrajtuara në liqen. UKT sh.a nuk ka kthyer një përgjigje të qartë lidhur me kërkesën për bashkëpunim të kërkuar nga APR, si dhe nuk rezulton të ketë kryer asnjë inspektim/ kontroll të mëtejshëm për verifikimin e situatës.

## **b. Qëllimi i auditimit**

Ky auditim trajton problematikat e evidentuara mbi ndotjen ujore dhe dëmtimin e botës së gjallë, në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese, sa është e mundur nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi shkaktuesit e ndotjes në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës.
- Masat parandaluese të marra për mbrojtjen mjedisore të basenit të Liqenit Artificial të Tiranës.
- Mbi masat e marra për përmirësimin e situatës së shfaqur në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe menaxhimi i qëndrueshëm.

## **c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave**

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar dokumentacionin që ka të bëjë me Vendime të Këshillit Bashkiak të Tiranës për kalimin e PMLAT në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit; Strukturën e APR për vitet 2021-2024 dhe rregulloret e brendshme; Shpenzimet e APR për mirëmbajtjen/ pastrimin e liqenit; Korrespondencat midis APR dhe institucioneve të tjera; Të dhëna nga UKT sh.a; Përgjigjet e pyetësorëve nga institucionet e varësisë së Bashkisë Tiranë; dokumentacionin e paraqitur nga APR dhe AKM; Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit, të publikuara në faqen zyrtare të AKM; monitorimet e realizuara nga ana e APR dhe AKM; Raport-analizat e kryera nga laboratorit i AKM; korrespondencat ndërmjet institucioneve; etj.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e auditimit si shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në terren, etj.

## **2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

### **d. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultuan mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, si në fazën e parandalimit, ashtu edhe në fazën e monitorimit dhe marrjes së masave për shmangien

e ndotjes mjedisore. Grupi i auditimit ka konstatuar gjetje dhe ka dhënë 8 rekomandime për masa organizative.

#### **e. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, është përcaktuar për t'u monitoruar për çdo vit, Liqeni Artificial i Tiranës. Në këtë program përcaktohen gjithashtu treguesit që duhen analizuar (përfshirë treguesit fiziko-kimikë, mikrobiologjikë, pesticidet, metalet e rënda, etj.) si dhe frekuenca përkatëse. Për periudhën objekt auditimi 2021-2024, por edhe përtej kësaj periudhe (minimalisht që nga viti 2015), AKM nuk ka realizuar asnjëherë monitorime vjetore për Liqenin Artificial të Tiranës.

- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, pavarësisht se ka evidentuar dhe faktuar edhe nga rezultatet e analizave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, se në liqen shkarkohen ujëra të ndotura urbane të patrajtuara (që në muajin tetor 2024), përveç korrespondencave shkresore, nuk ka marrë asnjë masë konkrete për evidentimin e shkaktarëve të ndotjes, marrjen e masave ndaj tyre si dhe zgjidhjen e problematikës. Nga korrespondencat shkresore të iniciuara nga APR ka rezultuar se AKUK nuk kanë kthyer përgjigje, ndërsa UKT sh.a nuk është përgjigjur konkretisht kërkesave të adresuara nga APR. Pra, bashkëpunimi ndërinstitucional nuk ka funksionuar, komunikimet mes institucioneve janë kufizuar në korrespondencë zyrtare, duke ndikuar drejtpërdrejtë në zvarritjen e problematikës dhe moszgjidhjen e situatës.

- Nga analizat e kryera nga AKM dhe interpretimi i tyre, ka rezultuar se në trupin ujqor të Liqenit Artificial të Tiranës ka shkarkime të ujërave të ndotura urbane. APR ka përcaktuar disa pika shkarkimi të mundshme, në të cilat AKM ka vijuar me kryerjen e analizave përkatëse. Pas rezultatit të këtyre analizave AKM ia ka deleguar ARM Tiranës ndjekjen e hapave të mëtejshme për kryerjen e inspektimeve në terren. ARM Tirana ka iniciuar inspektimin dhe e ka përmbyllur duke arsyetuar se subjektet në territorin e PMLAT nuk kanë leje mjedisore dhe rrjedhimisht nuk janë objekt i inspektimit të saj bazuar në fushëveprimin e saj. Pikat e evidentuara nga APR dhe AKM janë pikat shkarkimi të kanalizimeve të ujërave të bardha, që lidhen me pjesën e kodrave të Liqenit dhe "Liqenit të Thatë", rrjedhimisht këto shkarkime në pikat e identifikuar vijnë nëpërmjet rrjetit të kanalizimeve dhe nuk janë gjeneruar nga subjekte që operojnë në territorin e PMLAT. Për sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi subjektet që janë identifikuar, për të cilat ARM ka konkluduar se nuk disponojnë leje mjedisore dhe nga AKM e ARM Tirana nuk është kthyer përgjigje.

Nga verifikimi i kryer në terren nga grupi i auditimit u evidentuan se përpos shtatë pikave që janë identifikuar nga APR dhe marrë mostra për analizë nga AKM, ka dhe 3 pika të tjera të kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në liqen, të cilat ishin të dëmtuara, të bllokuara ose që kishin derdhje të ujërave të përdorura. Për këto pika nuk rezultoi të jenë marrë mostra dhe të jenë kryer inspektime. Për sa më sipër, pavarësisht se kemi pasur të bëjmë me një situatë kritike mjedisore, inspektimi i kryer nga ARM Tirana nuk ka qenë i plotë, si dhe nga ana e institucioneve nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për identifikimin e ndotësve, për të vlerësuar nëse ka edhe subjekte që disponojnë leje mjedisore, për të vijuar më tej me marrjen e masave për eliminimin e shkarkimeve të ujërave të patrajtuar/ të ndotur (urbane/ industriale, etj.) drejtpërdrejt në liqen.

- Referuar te dhënat e vëna në dispozicion, zona brenda Parkut të Madh të Liqenit Artificial nuk mbulohet nga rrjet kanalizimesh për ujërat e ndotura urbane. Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë nuk kanë asnjë informacion, si dhe nuk kanë kryer asnjë verifikim në terren, mbi metodat e trajtimit individual të ujërave të ndotura nga subjektet që operojnë brenda territorit të PMLAT.

Institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë (APR, UKT Sh.a, etj.) nuk kanë informacion mbi gropat septike të subjekteve që ndodhen në territorin e PMLAT, mbi vendndodhjen e tyre apo mbi menaxhimin/pastrimin e tyre, në mospërputhje me funksionet e bashkisë të përcaktuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 23, pika 2 "Në fushën e

infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, gjithashtu nuk ka një numër të saktë të subjekteve që operojnë në këtë territor.

- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka një strukturë në Drejtorinë e Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, për të garantuar përmbushjen e funksioneve kontrolluese, inspektuese, evidentuese të veprimtarive të jashtëligjshme, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme të saj. Si pasojë, nuk është evidentuar asnjë problematikë mjedisore ndër vite mbi shkaqe të mundshme të ndotjes së ujit të liqenit dhe nuk është kërkuar asnjëherë kryerja e analizave specifike për të vlerësuar gjendjen mjedisore të liqenit, përpara shfaqjes në sipërfaqe të ndotjes dhe marrjes së vëmendjes mediatike të problematikës së shfaqur.

#### **f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime, si vijon:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masat për kryerjen e monitorimit në stacionin e përcaktuar në Liqenin Artificial të Tiranës, sipas treguesve mjedisore, frekuencës dhe metodave të përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe të vendosë në dizenjimin Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkinë Tiranë për rezultatet e këtyre analizave.

- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, në rastet e mungesës së reagimit nga institucionet të cilave u është drejtuar për informacion apo bashkëpunim, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme institucionale për raportimin e problematikës në organet eprore përkatëse, me qëllim garantimin e funksionimit efektiv të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe shmangien e pasojave negative për ndotjen e liqenit.

- Bashkia Tiranë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrin masa për ngritjen e një grupi ndërinstytucional, me përfaqësi nga institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë dhe institucione të qeverisjes qendrore sipas fushëveprimeve përkatëse, për:

- Evidentimin e të gjitha pikave të shkarkimit të ujërave të përdorura/ të ndotura (urbane, industriale, etj.), duke përfshirë, edhe pikat e evidentuara nga grupi i auditimit, me qëllim:

- Ndjekjen e kanaleve të ujërave të shiut, për të evidentuar shkarkimet e jashtëligjshme të ujërave të përdorura në këto kanale;
- ndërprerjen e menjëhershme të lidhjeve të jashtëligjshme;
- evidentimin e ndotësve dhe marrjen e masave administrative sipas përcaktimeve ligjore kundrejt tyre.

- Për evidentimin dhe vlerësimin e gjendjes së gropave septike të subjekteve brenda territorit të PMLAT, për të garantuar operimin e tyre sipas standardeve dhe pa cenuar mjedisin.

### **3. Konkluzioni i auditimit<sup>4</sup>.**

Mbështetur në ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, audituam veprimtarinë e institucioneve, si Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në lidhje me ndotjen e shfaqur në Liqenin Artificial të Tiranës, duke krahasuar me kriteret e vlerësimit, përfshirë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtaritë e tyre.

Nga auditimi në terren, referuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion ka rezultuar se sistemi i menaxhimit, koordinimit institucional dhe infrastrukturës ekologjike në përgjithësi nuk ka funksionuar, duke e lënë hapësirën e LAT të pambrojtur ndaj ndotjes në mënyrë sistematike.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë konkluzionet si vijojnë:

---

<sup>4</sup> ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, pika 191.

Parku i Madh i Liqenit Artificial të Tiranës përfaqëson një aset të rëndësishëm natyror dhe social për qytetin e Tiranës. Për të siguruar që ky aset (*PMLAT së bashku me basenin e liqenit*) të ruhet, pastrohet dhe të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme për gjeneratat e ardhshme, nevojiten masa urgjente dhe një strategji afatgjatë. Nga auditimi i KLSH-së ka rezultuar se:

- Bashkia Tiranë, e cila është në rolin e administratores së PMLAT, nuk ka hartuar një plan menaxhimi të Liqenit Artificial të Tiranës, për ndarjen e detyrave, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale, për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit artificial të Tiranës, për të verifikuar e ndaluar të gjithë shkarkimet e ujërave të përdorura urbane, industriale, etj., që mund të vijnë si rrjedhojë e aktivitetit brenda territorit të PMLAT ose të përzierjes së jashtëligjshme të ujërave të zeza me kanalet e ujërave të bardha/ të shiut që shkarkojnë në liqen;
- Liqeni Artificial i Tiranës nuk ka një sistem qarkullues uji, por furnizohet vetëm me prurjen natyrore (ujërat e shirave);
- Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë (APR, UKT, DPN2) nuk disponojnë një hartë/plan shtrirje të rrjetit/sistemit të kanaleve të ujërave të shiut, të cilat derdhen në liqen. Nga auditimi u konstatua se kombinat e këtyre kanaleve janë të dëmtuara dhe nëpërmjet tyre evidentohen shkarkime të ujërave të ndotura.
- Territori i PMLAT nuk mbulohet nga rrjeti i kanalizimit, rrjedhimisht subjektet që operojnë brenda territorit të PMLAT-së e zgjidhin individualisht largimin e ujërave të ndotura urbane (p.sh. nëpërmjet gropave septike). UKT dhe institucionet e tjera të varësisë së Bashkisë Tiranë nuk kanë informacion mbi mënyrën e operimit të këtyre subjekteve lidhur me largimin e ujërave të ndotura urbane;
- Brenda territorit të Liqenit të Tiranës bazuar në kontratat e lidhura me UKT operojnë 10 subjekte private. Ndërkohë sipas përgjigjeve të APR rezultoi se operojnë 14 subjekte, pra ndërmjet institucioneve nuk ka një evidencë të saktë të numrit të subjekteve të cilat operojnë në zonën e PMLAT, gjithashtu nga verifikimet në terren i grupit të auditimit rezultoi se brenda PMLAT ka më shumë se 14 subjekte, të cilat, në mungesë të rrjetit të kanalizimeve brenda territorit të PMLAT, operojnë me zgjidhje individuale (si gropa septike), të cilat janë të pamonitoruara nga institucionet shtetërore;
- Asnjë nga institucionet e varësisë së Bashkisë Tiranë, përfshirë APR-në që administron PMLAT, nuk kanë informacion mbi vendndodhjen dhe gjendjen teknike të gropave septike.
- Në lidhje me ndotjen e shfaqur në Liqen nuk janë kryer asnjëherë analiza mikrobiologjike, por vetëm analiza fiziko-kimike;
- Edhe pse nga strukturat shtetërore është evidentuar që në muajin tetor 2024 (pra rreth 6 muaj më parë) se në Liqenin Artificial të Tiranës ka shkarkime të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara, aktualisht përveç korrespondencave shkresore, nuk janë marrë masa konkrete për evidentimin e shkaqeve dhe shkaktarëve të ndotjes, marrjen e masave për ndërprerjen e menjëhershme të shkaqeve që shkaktojnë ndotje, si dhe përmirësimin e situatës mjedisore në liqenin artificial të Tiranës. Bashkëpunimi ndërinstitutional për zgjidhjen e problematikës nuk ka funksionuar, fakt i shprehur edhe nga vetë strukturat e APR gjatë auditimit.
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, si struktura e varësisë së Bashkisë Tiranë që menaxhon parkun, nuk ka një strukturë në përmbushje të funksioneve kontrolluese, inspektuese, evidentuese të veprimtarive të jashtëligjshme brenda territorit të PMLAT-së;
- APR-ja në asnjë rast nuk ka evidentuar problematika që mund të shkaktonin ndotje dhe nuk ka kërkuar bashkëpunim nga strukturat e qeverisjes qendrore për analizimin e cilësisë së ujit në liqenin e Tiranës, përpara shfaqjes në sipërfaqe të ndotjes dhe marrjes së vëmendjes mediatike të situatës.
- Për periudhën objekt auditimi 2021–2024, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka shpenzuar 10,665,000 lekë për pastrimin e basenit të Liqenit Artificial të Tiranës. Ky

pastrim ka konsistuar vetëm në pastrim mekanik, pra heqje e plastikave nga sipërfaqja e liqenit, e bimisë së tepërt, etj., por jo i lidhur me reduktimin/eliminimin e elementëve që shkaktojnë ndotje në ujin e liqenit, të cilët janë në nivele të larta.

- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka realizuar procedurën e blerjes së mallrave me vlerë nën 100,000 lekë, për 10,000 copë rasat peshku, duke cituar “...në funksion të përmirësimit të ekosistemit ujor...”. Për të iniciuar këtë blerje, në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk administrohej një relacion teknik nga specialistë të fushës. Nga një verifikim rutinë i grupit të auditimit në datën 06.01.2025, rreth një muaj pas depozitimit të rasatit të peshkut në liqen (referuar PV të datës 04.12.2024), u konstatuan në brigjet e liqenit tufa peshqish të mbledhur në sipërfaqe (pasqyruar në fotot 10-11), çka mund të jetë pasojë e mungesës së oksigjenit në trupin ujor të Liqenit Artificial të Tiranës.
- AKM-ja nuk ka përmbushur detyrimin e monitorimit të treguesve të cilësisë së ujit në Liqenin Artificial të Tiranës, edhe pse ky stacion është i përfshirë në rrjetin e stacioneve të monitorimit, në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1350/1, datë 12.12.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 14.12.2024 deri më datë 21.03.2025, në subjektin Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë (APR, UKT sh.a, DPN2, etj.), për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2024, u krye auditimi tematik i përputhshmërisë “Mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. B.
2. D. P.
3. A. H.
4. P. I.
5. E. H.
6. J. H.

### 1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Ky auditim tematik ka si objekt përcaktimin e nivelit të zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “Kriteret e vlerësimit”. Ky auditim ka si qëllim:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, Vendime të Këshillit Bashkiak, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla etj.
- Aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse dhe rregulloret) dhe korrektësisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik), referuar ISSAI/IFPP 4900 të INTOSAI-t.
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen strukturat dhe personat përgjegjës për veprimet e tyre.

### 2. Identifikimi i çështjes

Referuar objektit të auditimit, u identifikuan çështjet për auditim, si më poshtë:

1. Mbi shkakun e ndotjes në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe vlerësimi mjedisor.
2. Masat parandaluese të mara për mbrojtjen mjedisore të basenit të Liqenit Artificial të Tiranës.

3. Mbi masat e marra për përmirësimin e situatës së shfaqur në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe menaxhimi i qëndrueshëm.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituar, lidhur me çështjen nën auditim**

Mbi përgjegjësitë e subjekteve nën auditim lidhur me PMLAT:

**Bashkia Tiranë** - mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e masave për mbrojtjen e ujit nga ndotja<sup>5</sup>, në nivel vendor. Në Bashkinë Tiranë për periudhën objekt auditimi ka qenë Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ku si funksion ka pasur të hartojë programe në përputhje dhe zbatim të politikave apo strategjive të fushës, të cilat synojnë adresimin e çështjeve kritike mjedisore dhe optimizmin e burimeve ekzistuese, në ngritjen e kapaciteteve për një zhvillim mjedisor të qëndrueshëm.

**APR** - bazuar në Vendimin nr.68, datë 27.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 23.09.2015, të Këshillit Bashkiak, "Për riorganizimin e drejtorisë së përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit", të ndryshuar, është përgjegjëse për mirë administrimin e Parkut të Madh të Liqenit<sup>6</sup> dhe gjithë infrastrukturës së tij, si dhe pastrimin e basenit ujqor<sup>7</sup>.

**UKT sh.a** - është përgjegjës për digën dhe mirëmbajtjen e saj<sup>8</sup>, rrjetin e kanalizimeve, pastrimin e gropave septike, me kërkesë dhe kosto të mbuluar nga subjekte të cilat kanë trajtim individual të ujërave të ndotura (gropa septike) në zonën e PMLAT.

**AKM** – Përgjegjëse për kryerjen e monitorimeve të mjedisit sipas PKMM-së<sup>9</sup> dhe bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore për të përcaktuar të dhënat mbi treguesit për mjedisin, si ujërat që ato kanë në administrim<sup>10</sup>.

### **4. Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së**

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara ligjore, nëse në tërësi nuk paraqiten anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit në të gjithë llojet e auditimit,

---

<sup>5</sup> Neni 26, pika 1

<sup>6</sup> Rregullorja e brendshme e APR-së.

<sup>7</sup> Vendim nr.68, datë 27.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 23.09.2015, të Këshillit Bashkiak, "Për riorganizimin e drejtorisë së përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit", të ndryshuar.

<sup>8</sup> Me vendimin e VKB nr. 35 datë 03.09.2015, diga e liqenit të Tiranës ka kaluar në administrimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë

<sup>9</sup> Në pikën 2.4 të PMM të miratuar çdo vit me Vendim të Këshillit të ministrave (pika 14 e monitorimit të stacioneve në liqeneve, ku përfshihet 1 pikë monitorimi në liqenin artificial të Tiranës)

<sup>10</sup> Vendim nr. 1189, datë 18.11.2009, "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit të monitorimit të mjedisit".

kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar.

## **5. Kriteret e vlerësimit**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t: ISSAI 400;
- Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”; ISSAI 100 “Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të IFAC;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;
- Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH.
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” i ndryshuar.
- Ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar
- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 23.09.2015, "Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit", të ndryshuar;
- Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 33, datë 23.05.2016 me të cilin ka ndryshuar Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 23.09.2015, ku i kalon për administrim Parku i Madh i Liqenit Artificial së bashku me asetet e tij;
- Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 27.06.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr. 41, datë 23.09.2015 ku në pikën 2 shtohet shkronja “g. Pastrimi i baseneve ujore të liqenit Artificial të Tiranës dhe liqenit të Farkës”;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 23.09.2015, "Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit", të ndryshuar;
- Rregulloret për funksionimin e APR për periudhat 2021-2024; etj.

## **6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: ISSAI/IFPP 100 “Parimet bazë në auditimin e sektorit publik”, ISSAI/IFPP 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI/IFPP 4000-4899 & 4900 “Udhëzues mbi kornizën ligjore dhe kriteret që do të merren parasysh gjatë shqyrtimit të aspekteve të rregullshmërisë dhe përshtatshmërisë në auditimin e përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI 140 “Sigurimi i cilësisë”;

ISSAI 130 “Kodi Etik”;

ISSAI 2315 “Risku”;

ISSAI 2500 “Dokumentimi”.

## **7. Metodatat e auditimit**

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe eficiencës së auditimit, duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional, të pavarur, të saktë, të plotë

e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, nga grupi i auditimit janë aplikuar:

- Verifikimi i transaksioneve, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga burime të ndryshme duke kryer krahasimin e tyre, me qëllim sigurimin e një evidence auditimi të saktë, të plotë, të përshtatshme për të bazuar konkluzionet e auditimit;
- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorë për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, grupi i auditimit ka përdorur pyetësorë drejtuar subjekteve të auditimit duke kërkuar informacion dhe verifikuar çdo raportim të tyre në lidhje me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportimin e situatës faktike.

## **8. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshime. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport i Auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm:**

*Liqeni Artificial i Tiranës është një prej atraksioneve kryesore të qytetit. Ai u ndërtua duke shfrytëzuar disa prurje ujore të zonës në vitin 1950, si pjesë e një projekti të madh për zhvillimin e qytetit. Fillimisht, ky liqen kishte si qëllim të shërbente për kontrollin e ujërave të shiut dhe për mbrojtjen e qytetit nga përmbytjet. Gjatë viteve, ai u transformua në një zonë rekreative, ku zhvillohen aktivitete të ndryshme rekreative, duke shërbyer gjithashtu si një hapësirë e rëndësishme ekologjike.*

*Me kalimin e viteve, Liqeni artificial i Tiranës ka fituar një rëndësi të madhe në jetën sociale dhe kulturore të Tiranës. Parku dhe liqeni artificial mbeten një nga zonat më të frekuentuara të kryeqytetit. Parku i Madh quhet ndryshe edhe mushkëria e qytetit, për shkak të bimësisë së shumtë, mbi 120 lloje pemësh, shkurresh dhe lulesh. Në park shfaqen disa lloje shpendësh, si Bilbili gushëkuq, Bilbili këngëtar, Bufi, Harabeli i gurëve, Shapka e vogël e ujit, Dallëndyshja e zakonshme, Gardelina, etj. Ndër kafshët që shfaqen në territorin e parkut mund të përmenden: Breshka, hardhuca, disa lloje gjarpërinjsh, kërmilli, dhe mjaft insekte që rriten nën tokë dhe mbi tokë.*

*Sipërfaqja aktuale e Parkut të Liqenit Artificial është 156.9 ha, ndërsa ajo e Liqenit Artificial është 4.5 ha.<sup>11</sup>*

## **2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

### **2.1. Mbi shkaku e ndotjes në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe vlerësimin mjedisor**

*Në tremujorin e fundit të vitit 2024, Liqeni Artificial i Tiranës u përball me një episod ndotjeje të theksuar, që u bë shqetësim publik dhe u trajtua gjerësisht në media. Një shtresë lënde e gjelbër-verdhë me aromë të pakëndshme u shfaq në sipërfaqe, pasojë e lulëzimit të Cianobakterit *Microcystis Aeruginosa*, i cili sinjalizon një gjendje të avancuar eutrofikimi. Analizat e kryera nga institucionet përkatëse dhe ekspertë të fushës evidentuan përmbajtje të lartë fosfatesh dhe mungesë oksigjeni të tretur, duke konfirmuar ndotjen e ujërave nga shkarkimet urbane dhe shkarkimet e tjera. Problem shtesë përbën mungesa e koordinimit institucional dhe e të dhënave mbi rrjetin e kanalizimeve dhe gropat septike, çka rrit rrezikun e përkeqësimit të mëtejshëm të situatës ekologjike.*

Me evidentimin e lëndës pezull mbi pasqyrën ujore të liqenit artificial të Tiranës, shoqëruar me aromë të pakëndshme, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, si institucioni përgjegjës për administrimin e PMLAT dhe pastrimin e basenit të Liqenit të Tiranës, nëpërmjet e-mailit të datës 16.10.2024, ka kërkuar nga AKM-ja kryerjen e analizave për të vlerësuar gjendjen ekologjike të ujit të liqenit. Nëpërmjet e-mail të datës 18.10.2024, Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit pranë AKM i ka nisur APR-së raport analizat për kampionet e marra dhe vlerësimin e rezultateve. Këto rezultate, APR-ja ia ka përcjellë Prof. A. M., pranë FSHN-së, nëpërmjet e-mail të datës 18.10.2024.

Në të njëjtën datë nëpërmjet e-mailit, prof. A. M., pranë FSHN-së, i ka kthyer përgjigje APR-së, ku ndër të tjera citohet “...gjendja nuk është për të hapur panik, por mbetet gjithnjë një sinjal për Bashkinë Tiranë, që vjen nga natyra”. Nëpërmjet këtij e-mail, është dërguar bashkëlidhur edhe një informacion/ raport më i detajuar, lidhur me situatën mjedisore të krijuar dhe gjendjen ekologjike të liqenit artificial të Tiranës, ku citohet se:

*“...Nga vëzhgimi arritëm në përfundimin se bëhet fjalë për një lulëzim të cianobakterit *Microcystis aeruginosa*... ndër të tjera qelizat e mikroscistis mund të prodhojnë anatoksina, mikrocistina, lipopolisakaride dhe BMAA. Këto helme lëshohen në mjedisin ujor gjatë shpërbërjes së qelizës dhe janë shpesh me pasoja të rënda për botën e gjallë ujore të liqenit, përfshirë këtu dhe shpendët ujorë, kafshët e tjera, përfshirë këtu edhe njeriun si përdorues të këtyre ujërave... këto lulëzime ndodhin dhe janë pasojë e pranisë së lëndëve ushqyese me tepriçë, veçanërisht fosfateve me origjinë nga shkarkimet e patrajuara urbane, por jo vetëm, edhe me origjinë bujqësore, blegtorale apo nga shërbimet e tjera. Kjo dukuri harxhon oksigjenin e tretur në ujë duke krijuar kushte anaerobe, dhe për rrjedhojë ngordhjen në masë të kafshëve (p.sh. peshqve) dhe bimëve ujore”.*

Nisur nga sa më sipër, APR-ja, si institucioni që ka nën administrim Liqenin e Tiranës, në kuadër të situatës së shfaqur, ka kërkuar informacion dhe marrjen e disa masave nga institucione të tjera shtetërore sipas kompetencave përkatëse, *trajtuar më specifikisht në pikën 2.3 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*

Eksperti i jashtëm i angazhuar në këtë auditim, Prof. B. B., ndër të tjera shprehet se:

*“Sa i takon vlerësimin kimiko-biologjik, nga një sondazh i kryer nga Departamenti i Inxhinierisë Kimike në Universitetin Politeknik të Tiranës rezultoi se përmbajtja e nutrienëve në mostrat e marra në liqen, gjatë muajit janar 2025 ishte shumë e lartë... Ujërat quhen të eutrofikuar kur përmbajtja e fosforit është 0.020 mg/L. Ndërkaq, analizat e kryera nga*

<sup>11</sup> <https://tirana.al/pika-interesi/parku-i-madh-i-liqenit-te-tiranës>

*Universiteti Politeknik të Tiranës treguan vlera shumëfish më të larta të përmbajtjes së fosforit, rreth 0.070 mg/L. Gjithashtu, përmbajtja e oksigjenit, edhe pse në periudhë dimri, ishte me një saturim rreth 55%, vlerë mjaft e ulët për këtë periudhë. Pa dyshim, në stinën e verës, përmbajtja e oksigjenit do të jetë më e ulët dhe gjendja do të përkeqësohet...*

*Gjatë vrotimit të liqenit, është vënë re një popullatë shumë e madhe e shpendëve, që tregon se në liqen shpendët kanë gjetur ushqim të bollshëm (biomasë e bollshme). Përmbajtja e rritur e nutrientëve (fosfateve, etj.), si dhe saturimi i vogël me oksigjen, tregon se ky liqen është në gjendje eutrofike ("i sëmurë"). Përkeqësimi i kësaj gjendje do ta bëjë të pamundur jetesën e gjallesave në këtë trup ujqor. Dukuria e ngordhjes së peshqve në mënyrë masive dhe dalja e tyre në sipërfaqe për shkak të mungesës së oksigjenit e konfirmon gjendjen e degraduar dhe praninë masive të shpendëve. Përmbajtja e lartë e nutrientëve dhe e ulët e oksigjenit tregon se në liqen ka shkarkime të shumta të substancave të pasura me azot dhe fosfor dhe të substancave reduktuese, të cilat konsumojnë oksigjenin. Gjithashtu, kur ka një akumulim të biomasës (bimësisë), pas "vdekjes" së bimëve ose algave, fillon procesi i dekompozimit, i cili kërkon oksigjen, duke ulur përmbajtjen e oksigjenit të tretur në ujë, veçanërisht në orët e errësirës, kur fotosinteza ndalon dhe ndodh respiracioni. Kjo e bën ekuilibrin e oksigjenit një faktor delikat, i cili duhet të monitorohet në liqen.*

*Rritja e temperaturave dhe zvogëlimi i vëllimit të ujërave ka gjasë të përkeqësojë situatën gjatë stinës së verës. Si rrjedhojë, kërkohet ndërhyrje e menjëhershme për të verifikuar e ndaluar të gjithë shkarkimet e ujërave të përdorura urbane, industriale, etj., që mund të vijnë si rrjedhojë e aktivitetit brenda territorit të PMLAT ose të përzierjes së jashtëligjshme të ujërave të zeza me kanalet e ujërave të bardha/ të shiut që shkarkojnë në liqen. Si rrjedhojë është e domosdoshme të kryhen analizat e ngarkesave të koliformëve fekale dhe totalë (CFU)".*

*Për sa më sipër, nëse nuk ndërhyhet me masa konkrete nga organet e qeverisjes qendrore dhe lokale, duke përfshirë dhe institucionet akademike e shkencore, bazuar edhe në vlerësimin e ekspertëve të fushës, ka gjasë të ndodhë përkeqësim i gjendjes, zhdukje e gjallesave, shfaqje e aromave të pakëndshme, duke u kthyer në shqetësim për vizitorët e parkut.*

### **Mbi gjendjen e kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në liqen**

Duke vlerësuar si shkaktues potencial të ndotjes prurjet e ujërave të ndotura nëpërmjet kanaleve të ujërave të shiut/ të bardha që derdhen në liqenin artificial të Tiranës, grupi i auditimit ka kërkuar një planimetri të shtrirjes së këtij rrjeti, informacion mbi gjendjen e tyre, si dhe procedurat përkatëse për pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, nga strukturat e varësisë së Bashkisë Tiranë, si APR, UKT dhe DPN2.

Për sa më sipër, APR bën me dije se nuk disponon planimetri të kanaleve të ujërave të shiut dhe se nga punonjësit e këtij institucioni, kryhet vetëm pastrimi fizik i mbetjeve të dukshme, si p.sh. gjethe, degë, materiale plastike/ plastmasi, kartona, letra, etj. Ky lloj pastrimi kryhet rregullisht në mënyrë që ato të jenë të pastra dhe të mos krijojnë problematika me reshjet e dendura.


Gjithashtu edhe Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes, Rrugë, Ndriçim, Sinjalistikë (DNP 2), në përgjigjen e pyetësorit dërguar elektronikisht në datën 12.03.2025, bën me dije se nuk disponon hartë/ planimetri të kanaleve të ujërave të shiut, pasi liqeni i Tiranës nuk menaxhohet nga kjo drejtori. Në shkresë citohet se "nga verifikimet e kryera nga një grup i ngritur për këtë çështje rezultoi që në liqenin artificial të Tiranës nuk ka asnjë pikë shkarkimi të ujërave të shiut, pasi ato shkarkohen në kolektorët e ujërave të zeza të cilat menaxhohen nga UKT sh.a". Ndërsa UKT, në përgjigjen e pyetësorit dërguar elektronikisht në datën 18.03.2024, shprehet se "Referuar rrjetit të largimit të ujërave të shiut ju informojmë se administrimi dhe mirëmbajtja e tyre nuk bëhet nga UKT, por nga Bashkia Tiranë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, si dhe APR që menaxhon territorin e PMLAT". Pavarësisht se në shkresat e institucioneve të varësisë së Bashkisë Tiranë dhe dokumentacionin e gjeneruar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit citohet se "është konstatuar se në 6 nga 8 pikat

*e shkarkimit të ujërave të bardha kishte rrjedhje”, asnjë nga institucionet e varësisë së Bashkisë Tiranë (që drejtpërdrejt ose tërthorazi lidhen me administrimin e atij territori, pastrimin e mirëmbajtjen së kanaleve të ujërave të shiut apo të rrjetit të kanalizimeve), nuk administrojnë një planimetri të këtyre kanaleve të ujërave të bardha që derdhen në liqen, për të evidentuar shtrirjen dhe rrugën që kanalet ndjekin, për t’u derdhur në fund në liqen, njëkohësisht për të vlerësuar zonat urbane nëpërmjet të cilave këto kanale kalojnë dhe që mund të kenë ndërhyrje në mënyrë të jashtëligjshme duke lidhur kanalizimet e ujërave të zeza me kanalet e ujërave të shiut.*

Për këtë situatë, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar informacion nga Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, nëpërmjet shkresës nr. 1350/4 prot., datë 11.03.2025, për të cilën është kthyer përgjigje nga IKMT nëpërmjet shkresës administruar në KLSH me nr. 1350/6 prot., datë 21.03.2025, ku citohet se *“grupi i punës kreu një verifikim më të hollësishëm në pikat e përcaktuara që krijoheshin ndotje, ku rezultoi se këto ndotje vijnë si rrjedhojë e përzierjes së ujërave të bardha me ujërat e ndotura urbane, për shkak të mosfunksionimit apo mungesës së kanalizimeve në këtë zonë. Këto janë rrjedha të lira që vijnë nga tombinat e rrugëve, të cilat janë të përziera me ujërat e ndotur që vijnë nga pjesa e urbanizuar e zonës, përkatësisht zona e Liqenit të Thatë dhe shkarkohen në liqenin artificial të Tiranës, duke shkaktuar ndotjen e ujit”,* për të cilën IKMT u është drejtuar me shkresën nr. 316/2 prot., datë 16.01.2025 UKT, si dhe për dijeni APR dhe ARM Tiranë, ku kërkohet *“Marrja e masave të menjëhershme për diferencimin e ujërave të bardha dhe të ndotura, rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve (ky është shkaku kryesor për ndotjen e liqenit), si dhe mbylljen/ izolimin e pikave që shkarkojnë ujëra të ndotura në liqen”.*

Nga verifikimi në terren, i kryer nga grupi i auditimit, u konstatuan raste ku tombinat e kanaleve të ujërave të shiut ishin plotësisht të bllokuar, ose kishte rrjedhje potencialisht të ujërave të ndotura, si dhe aromë të pakëndshme (disa nga rastet paraqitura në fotot më poshtë).

**Foto 5-9:** Foto nga verifikimi në terren i grupit të auditimit në datën 06.03.2025: Gjendja e tombinave të kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në PMLAT





**Burimi:** Grupi i auditimit

Nga verifikimi në terren, grupi i auditimit ka konstatuar raste të dëmtimit të tombinave të kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në liqen (të paraqitura në figurën më poshtë), të cilat ishin të bllokuara ose kishte derdhje të ujërave të ndotura, sipas pikave (10 pika, ndër të cilat vetëm 7 pika ishin identifikuar nga APR dhe marrë mostra për analizë nga AKM) të përcaktuara në hartën më poshtë:

**Figura 1:** Pikat problematike të identifikuara nga grupi i auditimit gjatë verifikimit në terren




**Burimi:** Grupi i auditimit

### **Mbi rrjetin e kanalizimeve brenda territorit të PMLAT**

Referuar të dhënave nga APR dhe UKT, brenda territorit të PMLAT ushtrojnë aktivitet mbi 10 subjekte (APR liston 14 subjekte, UKT liston 10 subjekte).

Figura 2. Rrjeti i kanalizimeve, Burimi: UKT sh.a.



**Burimi:** UKT sh.a

Referuar Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 2 në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga UKT dhe APR mbi infrastrukturën e menaxhimit të ujërave të ndotura urbane brenda territorit të PMLAT (rrjet kanalizimesh, gropa septike, etj.). Pavarësisht se ka nën administrim territorin e PMLAT, APR-ja bën me dije se nuk disponon informacion të tillë, pasi janë struktura të tjera shtetërore që japin leje apo kontrollojnë infrastrukturën e menaxhimit të ujërave. Nga ana e UKT bëhet me dije se brenda territorit të PMLAT nuk ka rrjet kanalizimesh, pra rrjedhimisht subjektet që operojnë brenda territorit të PMLAT nuk janë të lidhur me rrjetin e kanalizimeve dhe ujërat e ndotura urbane/ ujërat e përdorura nuk shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve, por në mënyra alternative (sikurse mund të jenë gropat septike). Pavarësisht sa më sipër, asnjë nga institucionet e varësisë së Bashkisë Tiranë nuk e disponon këtë informacion.

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi mënyrën e kryerjes së monitorimit, mirëmbajtjes dhe pastrimit të gropave septike të subjekteve që ushtrojnë aktivitete brenda territorit të PMLAT. APR bën me dije se nuk disponon një informacion të tillë. Nga UKT sqarohet se, në bazë të Kodit të Ujit, pika 1.6 (1), (2), (5), largimi i ujërave të ndotura në zonat ku UKT sh.a nuk disponon rrjet, realizohet me gropë septike e cila do të ndërtohet dhe mirëmbahet nga vetë subjekti deri në momentin kur në zonë të jetë ndërtuar një sistem kanalizimi nga UKT sh.a. Referuar kësaj, subjekti merr masa për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e puseve dhe gropave septike. Pra, asnjë nga institucionet nuk ka kryer dhe nuk kryen monitorim të gropave septike, gjendjes teknike të tyre, shkarkimeve, etj.

Referuar nenit 7 të Ligjit nr. 9115 datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Bashkia Tiranë, në cilësinë e institucionit përgjegjës për menaxhimin e ujërave të ndotura urbane duhet të sigurojë zbatimin e kërkesave teknike, metodike dhe organizative për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura. Shkarkimet urbane i nënshtrohen trajtimit mjedisor paraprak, i cili përfshin: a) ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për lëvizjen e ujërave të ndotura nga banesat drejt rrjetit të kanalizimeve urbane; b) ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve të shkarkimeve të lëngëta, në zonat urbane dhe rurale, duke respektuar kriteret e mbrojtjes së mjedisit; d) ndërtimin dhe funksionimin e impianteve të trajtimit të tyre para shkarkimit në ujërat sipërfaqësore; etj.

APR-ja administron tualetin publik brenda territorit të PMLAT, i cili operon me gropë septike. Për këtë objekt, APR-ja shprehet se pastrimi kryhet të paktën dy herë në javë, me punonjës dhe mjete të APR (bot) dhe se aktualisht nuk ka një institucion/ inspektorat shtetëror mbi respektimin e standardeve mjedisore, i cili të ketë kryer një kontroll apo inspektim për këtë proces.

### **Të dhëna mbi rrjetin e kanalizimeve në zonën te kodrat e liqenit**

Grupi i auditimit ka kërkuar të dhëna nga UKT sh.a, për zonën përreth liqenit (ana përtej Unazës, kodrat e liqenit). Nga UKT janë vënë në dispozicion të dhënat, ku konstatohet se në hark kohor prej 5 vitesh, numri i klientëve është rritur me thujse 15%, sipas paraqitjes në tabelë:

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
<b>Popullsia</b>						
<b>Numri i klientëve</b>	3602	3705	3810	3940	4060	4206
<b>Shkalla e lidhjes – kanalizime (%)</b>	91%	93%	93%	95%	96%	96%
<b>Vëllimi mesatar i ujërave të ndotur/ frymë</b>	117 m3/v	110 m3/v	114 m3/v	114 m3/v	112 m3/v	115 m3/v
<b>Sasia e ujit të ndotur të faturuar (m3/vit)</b>	422.032	408.904	433.684	450.923	455.256	484.064

Burimi: UKT sh.a.

Nisur dhe nga qëndrimi i IKMT-së, ku citohet se “*këto rrjedha të lira nga tombinat të cilat janë të përziera me ujërat e ndotur që vijnë nga pjesa e urbanizuar e zonës, përkatësisht zona e Liqenit të Thatë dhe shkarkohen në Liqenin artificial të Tiranës, duke shkaktuar ndotjen e tij*”<sup>12</sup>, rritja e numrit të klientëve të UKT-së dhe rrjedhimisht të ujërave të ndotur të gjeneruar prej tyre, mund të ketë pasur ndikim negativ në situatën aktuale.

### **Mbi gjendjen e portave të digës së liqenit**

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi gjendjen e portave të digës së liqenit. Nga UKT sh.a është bërë me dije se, referuar VKB-së nr. 35 datë 03.09.2015, diga e liqenit të Tiranës ka kaluar në administrimin e UKT sh.a. UKT-ja kryen kontroll të vazhdueshëm mbi gjendjen e trupit të digës dhe për nivelin e ujit të këtij liqeni, nivel i cili matet nëpërmjet njërive metrike (lat metrike), duke theksuar se deri me tani nuk ka pasur probleme me trupin e digës apo me sasinë e ujit në liqen, probleme të cilat do të kërkonin një hapje të portave të kësaj dige. UKT citon se “*portat e kësaj dige, që në kohën kur kjo digë është marrë në administrim nga UKT sh.a, kanë pasur probleme me komandimin, për shkak të një avarie dhe hapje të pakontrolluar të këtyre portave (kjo rreth viteve 2001-2002)*”. Nga UKT bëhet me dije se për zgjidhjen teknike për sa i përket qëndrueshmërisë së digës (jetëgjatësisë së saj), rikonstruksionit apo edhe zëvendësimit të pjesëve përbërëse të digës, sikurse mund të jenë portat e shkarkimit, etj., nga ana e Bashkisë Tiranë është hartuar një projekt, i cili aktualisht është në fazë shqyrtimi pranë Institutit të Ndërtimit dhe Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

## **2.2. Masat parandaluese të marra për mbrojtjen mjedisore të basenit të Liqenit Artificial të Tiranës.**

*Pavarësisht detyrimeve ligjore dhe sinjaleve të hershme për ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës, institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa të mjaftueshme parandaluese për mbrojtjen e këtij trupi ujqor. Monitorimi mjedisor i liqenit, i përcaktuar në programet kombëtare të paktën që prej vitit 2015, nuk është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, duke lënë kështu një boshllëk të rëndësishëm në monitorimin dhe mbikëqyrjen e treguesve ekologjikë të këtij trupi ujqor. Po ashtu, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka ushtruar funksione*

<sup>12</sup> Shkresa e Kryeinspektorit të IKMT-së nr. 316/2 prot., datë 16.01.2025, drejtuar UKT-së, për dijëni APR-së dhe ARM-së Tiranë.

*menaxhuese dhe inspektuese efektive, ndërkohë që Bashkia Tiranë nuk ka hartuar asnjë plan menaxhimi për Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, përfshirë basenin e liqenit. Reagimi institucional ka qenë i vonuar dhe i pjesshëm, i nxitur vetëm pas shfaqjes së ndotjes së dukshme në vitin 2024, duke dëshmuar mungesë koordinimi dhe përgjegjshmërie për një problematikë të vazhdueshme me pasoja serioze për mjedisin dhe komunitetin.*

### **Mbi monitorimin e trupit ujor “Liqeni artificial i Tiranës”**

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në mbështetje të VKM-së nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, pikat B4.1 a-f, B4.2 a-b, Ç4-b, realizon monitorimin e ujërave sipërfaqësorë. Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit (PKMM) hartohet çdo vit nga AKM dhe miratohet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit. Për hartimin e këtij programi, AKM bashkëpunon me: a) ministritë, në përputhje me fushën, që mbulon ministria konkrete, për të përcaktuar të dhënat dhe treguesit, që ajo do të grumbullojë për mjedisin; b) organet e qeverisjes vendore për të përcaktuar të dhënat e treguesit për mjedisin, që ato kanë në administrim, sidomos për mjediset urbane, për administrimin e mbetjeve, për ujërat, për pyjet e kullotat komunale, për shfrytëzimin etj.

Stacionet e monitorimit janë përcaktuar nga Projekti CEMSA<sup>13</sup>, iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian, që synonte konsolidimin e sistemit të monitorimit mjedisor në Shqipëri dhe përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në kuadër të këtij projekti, u ngrit një rrjet i gjerë stacionesh monitorimi për të mbikëqyrur komponentë të ndryshëm mjedisorë, ku ndër të tjera është përcaktuar rrjeti i stacionit të monitorimit të ujërave sipërfaqësore liqene, në total 36 stacione në rang kombëtar. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ujërat sipërfaqësorë deri në 2013 janë monitoruar me kontratë shërbimi nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe nga 2014 programi i monitorimit është ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Në PKMM-të përkatëse për vitet objekt auditimi (2021 – 2024), në tabelën 6 të Akt konstatimit të mbajtur me AKM, janë paraqitur stacionet e monitorimit për liqenet, ku me numër rendor 14 është listuar edhe Liqeni i Tiranës për tipin e kampionimit “WS (W- ujë; S- sediment)”. Në PKMM përcaktohet se:

Sa i përket treguesve që do të analizohen: Të gjithë treguesit fiziko-kimikë që maten në stacionet lumore, maten edhe në stacionet e liqeneve dhe lagunave, duke shtuar tejdukshmërinë (disku Secchi, m), ngjyra, lëndët e ngurta pezull (TSS), lëndët e tretura pezull (TDS), materialet notuese (in situ) regjimi hidrologjik, kushtet morfologjike, parametra të tjerë biologjikë, si fitoplanktoni, zooplanktoni, makrofitet dhe fitobentosi, perifitoni, fauna invertebrore bentike, makroinvertebrorët, prodhimtaria parësore (biomasa), fauna e peshqve, pigmentet fotosintetike (klorofilet), algat helmuese, biotoksinat, etj.;

Sa i përket frekuencës, ajo përcaktohet 4 herë në vit për nutrientët e ujit, minimalisht 2 herë në vit për vlerësimet biologjike nëpërmjet organizmave bentikë dhe 1 herë në vit për parametra dhe mostra të tjera;

Sa i përket metodës së kampionimit, kampioni do të merret me shishe Ruttner, në thellësi 0m, 5m, 10m (sipas thellësisë së liqenit);

Sa i përket tipit të kampionimit, përcaktohet Ujë dhe Sediment.

Referuar PKMM-së së vitit 2015<sup>14</sup> (më i hershmi i aksesueshëm në faqen zyrtare të AKM), por edhe atyre në vazhdimësi, sa i përket liqeneve, ku përfshihet dhe stacioni i monitorimit në liqenin e Tiranës, përcaktohet se parametrat që do të analizohen janë pH, O<sub>2</sub>, kripësia, TOC, PM, ushqyes, metalet e rënda, organizmat bazë, dhe në një fazë të dytë përbërjet e klorurit,

<sup>13</sup> Consolidation of the Environmental Monitoring System in Albania

<sup>14</sup> [https://akm.gov.al/ova\\_doc/programi-kombetar-i-monitorimit-te-mjedisit-per-vitin-2015](https://akm.gov.al/ova_doc/programi-kombetar-i-monitorimit-te-mjedisit-per-vitin-2015)

PCB-të, si dhe pesticidet dhe PAH-të. Frekuenca minimale e monitorimit është 4 herë në vit për ushqyesit e ujit dhe një herë në vit për kampionet dhe parametrat e tjerë.

Nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të aktivitetit monitorues të AKM në stacionin e monitorimit në liqenin e Tiranës. AKM-ja ka bërë me dije se “*nuk ka monitorim të liqenit të Tiranës si një trup uJOR artificial, pasi stacionet e përcaktuara janë detyrim dhe prioritet, ndërsa liqeni i Tiranës nuk ka qenë i përfshirë në programin tonë vjetor të monitorimit*”. Pra, pavarësisht se në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (për të cilin AKM ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin) është përcaktuar minimalisht që nga viti 2015 stacioni i monitorimit në liqenin e Tiranës, duke përcaktuar monitorimin e vazhdueshëm të këtij trupi uJOR sipas treguesve dhe frekuencës së përcaktuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk e ka përfshirë në planin vjetor të monitorimeve duke mos e parashikuar tek stacionet me prioritet dhe për pasojë nuk ka kryer monitorim.

### **Analizat e vetme të kryera nga AKM në Liqenin Artificial të Tiranës**

Në vitin 2015, AKM-ja ka realizuar një monitorim për liqenet e Tiranës dhe të Farkës, por raporti me rezultatet e këtij monitorimi nuk është publikuar. Me konkretisht, nëpërmjet e-mail të datës 19.12.2024, Përgjegjësi i Sektorit të Laboratorit në AKM ka venë në dispozicion të grupit të auditimit raportin mbi treguesit fiziko-kimikë për liqenin e Tiranës, ku sqaron se ky material nuk është botuar, pasi është ndërmarrë për vlerësim të cilësisë së liqenit për qëllime studimi. Grupi i auditimit ka kërkuar praktikën e plotë të monitorimit të kryer për këtë qëllim, por nga AKM është bërë me dije se në vitin 2015 liqeni nuk ka qenë pjesë e programit të monitorimit, por është realizuar kampionim me qëllim për një emision televiziv.

Dokumenti “*Monitorim i cilësisë së liqeneve të Tiranës*” përfshin kampionimin në Liqenin e Tiranës dhe Liqenin e Farkës, duke përcaktuar për liqenin e Tiranës koordinatat N 41°18’35” dhe E 19°48’51”. Grupi i auditimit ka siguruar rezultatet e këtij monitorimi të cilat janë pasqyruar në tabelën më poshtë.

**Tabela nr.1:** Rezultatet e analizave mbi mostrën e marrë në liqenin artificial të Tiranës viti 2015

<b>Nr.</b>	<b>Parametrat</b>	<b>Diga e Liqenit të Tiranës</b>
1.	pH	8.32
2.	Konduktiviteti	334 µS/cm
3.	TDS	336 mg/l
4.	Saliniteti	0.1
5.	Oksigjeni i tretur (in situ)	8 mg/l
6.	Nevoja kimike për oksigjen	9 mg/l
7.	Nevoja biokimike për oksigjen	9 mg O/l
8.	N-NO <sub>3</sub>	0.15 mg/l
9.	N-NO <sub>2</sub>	0.004 mg/l
10.	N-NH <sub>4</sub>	0.022 mg/l
11.	P – PO <sub>4</sub>	0.02 mg/l
12.	Fosfori total	0.036 mg/l

**Burimi:** AKM

Bazuar në këto rezultate në Dokumentin “*Monitorim i cilësisë së liqeneve të Tiranës*” citohet se “*Nga rezultatet e analizave gjykojmë që ujërat janë të ngopura me oksigjen me vlera që variojnë nga 8 – 9 mg/l (për mostrën e marrë në liqenin e Tiranës është 9mg/l)... Përmbajtja e fosforit është faktori kryesor që përcakton shkallën e eutrofikimit në ujërat e liqenit*”.

Sa i përket Nevojës Kimike për Oksigjen (COD) në analizën e mostrës së marrë në Liqenin e Tiranës, rezultuar 9mg/l, është në kufi të cilësisë mesotrofike, bazuar në parametrat kimike të Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EC;

Sa i përket *Nevojës Biokimike për Oksigjen (BOD<sub>5</sub>)* në analizën e mostrës së marrë në Liqenin e Tiranës, rezultuar 9mg O<sub>2</sub>/l, klasifikohet cilësi *eutrofike*, bazuar në parametrat kimike të Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EC;

Sa i përket *Fosforit total (P total)* në analizën e mostrës së marrë në Liqenin e Tiranës, rezultuar 0,036 mg/l (36 µg P/l), klasifikohet cilësi *eutrofike*, bazuar në parametrat kimike të Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EC.

Në dokumentin e paraqitur nuk janë interpretuar këto analiza, shkaqet dhe pasojat e këtyre treguesve, për të vijuar me ndërmarrjen e hapave të nevojshme për mbrojtjen mjedisore në Liqenin Artificial të Tiranës. Pavarësisht këtyre rezultateve të vitit 2015, të iniciuara sikurse cituar për qëllime studimore, **ku është konstatuar niveli i ndotjes në liqenin e Tiranës**, pa marrë parasysh edhe ndryshimet e mëdha në zonë, ndërtimin e objekteve të reja, shtimin e aktiviteteve tregtare, rritjen e frekuentuesve, etj., në asnjë vit Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka vlerësuar me risk dhe të nevojshme kryerjen e inspektimeve/ monitorimeve pasuese, me qëllim evidentimin e shkaqeve që sjellin ndotjen. Për sa më sipër, niveli i ndotjes në Liqenin artificial të Tiranës është konstatuar që në vitin 2015.

### **Mbi funksionet inspektuese të AKM/ ARM**

VKM nr. 112, datë 02.03.2022 përcakton fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në pikën 2 të këtij akti përcaktohet se MTM ka si mision, ndër të tjera, hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë *mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit*, etj. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, institucion varësie i ministrisë përgjegjëse për mjedisin (përkatësisht MTM-së), e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në VKM nr. 568, datë 17.07.2019 “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM*”, i ndryshuar. Në pikën I.2 të këtij akti përcaktohet se AKM-ja ka për mision *mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin* e mjedisit, duke përcaktuar ndër përgjegjësitë funksionale të AKM sigurimin e performancës mjedisore dhe inspektimin e kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore. Në pikën III.5.4 përcaktohet se në lidhje me inspektimin dhe kontrollin e veprimtarive lidhur me sektorin e mjedisit dhe ujërave, AKM siguron kontrollin shtetëror të mbrojtjes së mjedisit, kryen inspektime dhe kontrole për respektimin e kërkesave ligjore dhe kushteve mjedisore, *siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit dhe ujërave.*

Nëpërmjet Urdhrit nr. 29, datë 30.08.2023 të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror është ndarë fushëveprimi i dy inspektorateve (IKMT-së dhe AKM-së) lidhur me fushën e mjedisit, duke kufizuar AKM-në të ushtrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë së aktivitetit të operatorëve me kushtet/ kriteret e përcaktuara në lejet mjedisore dhe inspektorët e AKM-së, nëse marrin indicie apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qendror dhe IKMT-në për kompetencë. Pavarësisht se strukturat e AKM-së kanë njoftuar IKMT-në (pa njoftuar njëkohësisht edhe Inspektoratin Qendror), në zbatim të Urdhrit të mësipërm, nga dokumentacioni i venë në dispozicion nuk rezulton të janë marrë masa për kryerjen e inspektimeve, evidentimin e ndotësve, caktimin e masave përkatëse administrative dhe ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit ndotës, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

Për gjithë sa më sipër, pavarësisht se ka pasur kërkesa dhe indicie të vazhdueshme nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, janë analizuar mostra dhe është *konstatuar dhe konfirmuar nga vetë AKM-ja*, nëpërmjet laboratorit të saj të akredituar se *ka shkarkime të ujërave të ndotur të patrajtuar në liqen*, strukturat inspektuese të AKM-së nuk kanë marrë asnjë masë për të mbrojtur, ruajtur dhe përmirësuar mjedisin, duke pretenduar se Agjencia Rajonale e Mjedisit nuk mund të kryejë inspektime përderisa asnjë nga subjektet nuk ka leje mjedisore. Nuk është e qartë se cilëve subjekte u referohet ARM Tiranë, pasi mostrat janë marrë në kanalet e shkarkimit në liqen të ujërave të bardha, të cilat lidhin me anën tjetër të autostradës nga kodrat

e liqenit. Në vend të veprimeve konkrete, pasi jemi përpara faktit të ndotjes së mjedisit dhe natyrës, AKM-ja është mjaftuar vetëm me një shkresë drejtuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ku tregon evidentimin se në shtatë pika të shkarkimit të ujërave të bardha kishte rrjedhje, pra ndotje organike potencialisht të ardhura nga ujëra të ndotura urbane (ujëra të zeza).

### **Mbi Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit**

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit është një institucion varësie i Bashkisë Tiranë, krijuar me Vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës me nr. 41, datë 23.09.2015 “Për Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 88, datë 26.07.2017 dhe vendimin nr. 68, datë 27.06.2024. Në VKB nr. 41, datë 23.09.2015 është vendosur krijimi i APR si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës me një numër të përgjithshëm prej 200 punonjësish ku detyrat funksionale janë, si më poshtë:

- 1) Administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve memoriale, (Varrezat e Dëshmorëve Tiranë dhe Pezë), brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
- 2) Zhvillimi, administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve rekreative (përfshirë Parkun Zoologjik), historike dhe natyrore, brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Kthimi i parqeve, nëpërmjet planifikimit dhe projekteve, në zona rekreative të frekuentuara nga të gjitha grupmoshat.
- 3) Kthimi i parqeve nëpërmjet planifikimit dhe projekteve në zona rekreative të frekuentueshme nga çdo grupmoshë
- 4) Mbrojtja e kursorave të gjelbra dhe inspektimi i respektimit të zonave të gjelbra brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Ky vendim është ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak me nr. 88, datë 26.07.2016, ku APR-së ndër detyrat që ka, i është shtuar edhe administrimi i aseteve rekreative dhe sportive, (terrene, kënde, pishina, fusha, palestra, sheshe, vegla pajisje, pista e shtigje, ambiente rekreative e sportive që ndodhen në territorin e Bashkisë Tirane.

Më pas me VKB me nr.68 datë 27.06.2024 APR-së i kaloi edhe **pastrimi i baseneve ujore të Liqenit Artificial dhe liqenit të Farkës.**

**Pra, bazuar në sa më sipër, APR** është përgjegjëse për mirë administrimin e Parkut të Madh të Liqenit<sup>15</sup> dhe gjithë infrastrukturës së tij, si dhe pastrimin e basenit ujqor<sup>16</sup>.

Në strukturën e saj APR ka një drejtori të dedikuar për administrimin e Parkut të madh të liqenit – **Drejtoria e Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit**

Kjo drejtori përgjatë viteve periudhë auditimi ka pësuar ndryshim në strukturë, ku në vitin 2021<sup>17</sup> Drejtoria e Administrimit të PMLAT përbëhej nga 1+87 punonjës, të drejtuar në: (i) Sektori i Inspektim Monitorimit i përbërë nga 1 përgjegjës dhe 8 specialistë/inspektorë; (ii) Sektori i Gjelbërimit, i përbërë nga 1 përgjegjës, 2 specialistë dhe 32 punëtorë; (iii) Sektori i Pastrimit të parkut, i përbërë nga 1 përgjegjës, 1 specialistë dhe 31 punëtorë; (iv) Sektori i Objekteve dhe Shesheve Rekreative i PMLAT, i përberë nga 1 përgjegjës, 1 specialist, 2 teknik dhe 6 punëtorë. **Pra, në vitin 2021 Drejtoria e Administrimit të PMLAT kishte dhe Sektor inspektimi dhe monitorimi që përbehej nga 1 përgjegjës dhe 8 specialistë/inspektorë.**

Sipas rregullores së APR të miratuar me Vendimin nr. 24593/1, datë 27.06.2019 Drejtoria e Administrimit të PMLAT, kishte si funksion ndër të tjera të:

- **Të kontrollojë dhe të inspektojë** Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, duke garantuar ruajtjen e të gjithë aseteve të tij, ndër to dhe pasqyrat ujore, shatërvanë etj.;

<sup>15</sup> Rregullorja e brendshme e APR-së.

<sup>16</sup> Vendim nr.68, datë 27.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 23.09.2015, të Këshillit Bashkiak, “Për riorganizimin e drejtorisë së përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, të ndryshuar.

<sup>17</sup> Referuar Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. 2850/1 datë 20.01.2022

- **Të evidentojë të gjitha problematikat** që lidhen me kontrollin dhe ndalimin e aktiviteteve të paligjshme në PMLAT etj.

Aktualisht, në strukturën e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit<sup>18</sup> bën pjesë Drejtoria e Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit (PMLAT), me strukturë prej 1+91 punonjësish, të detajuar në: (i) Sektori i Gjelbërimit dhe Pastrimit të Parkut Qendror, i përbërë nga 1 përgjegjës, 3 specialistë dhe 46 punëtorë; (ii) Sektori i Gjelbërimit dhe Pastrimit të parkut jugor, i përbërë nga 1 përgjegjës, 2 specialistë dhe 20 punëtorë; (iii) Sektori i Administrimit të Objekteve, i përbërë nga 1 përgjegjës, 2 specialistë, 2 teknikë, 6 punëtorë, 2 biletashitës; (iv) Sektori “Pedalo në park – pedalo kudo”, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.

Sa më sipër, Drejtoria e Administrimit të PMLAT nuk ka më punonjës “Inspektorë”. Sektori i Inspektim Monitorimit nuk është më pjesë e strukturës së Drejtorisë së Administrimit të PMLAT që prej vitit 2022. Megjithatë, rregullorja e PMLAT përcakton funksione kontrolluese, inspektuese dhe evidentuese për problematikat që lidhen me kontrollin dhe ndalimin e aktiviteteve të paligjshme në PMLAT. Pavarësisht se rregullorja është përditësuar me disa ndryshime, funksionet e përmendura në pikat më sipër nuk kanë ndryshuar.

### **Mbi planin e menaxhimit të Liqenit Artificial të Tiranës**

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tiranë dhe APR nuk kanë hartuar një Plan për Menaxhimin e Liqenit Artificial të Tiranës. Grupi i auditimit vlerëson se, duke qenë se mirëmenaxhimi i PMLAT, përfshirë parkun dhe liqenin, kërkon angazhim jo vetëm të APR-së, por edhe bashkërendim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me institucione të tjera të varësisë së Bashkisë Tiranë dhe institucione të tjera të qeverisjes qendrore, të specializuara në fushën e mbrojtjes mjedisore, të menaxhimit të burimeve ujore, të inspektimit dhe mbrojtjes së territorit, etj. Mungesa e menaxhimit efikas, koordinimit ndër-institucional dhe infrastrukturës ekologjike e kanë lënë këtë hapësirë të pambrojtur ndaj ndotjes. Një strategji afatgjatë do të ishte e domosdoshme për të siguruar që PMLAT së bashku me basenin e liqenit, të ruhet, të pastrohet dhe të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme në vazhdimësi.

### **Mbi rolin kontrollues dhe inspektues të APR mbi aktivitetet e paligjshme në PMLAT**

Nisur nga fakti se në Rregulloren e Brendshme të APR përcaktohen detyrat e Drejtorisë së PMLAT, si (i) kontrolli dhe inspektimi i PMLAT, duke garantuar ruajtjen e të gjithë aseteve të tij, si dhe (ii) evidentimi i të gjitha problematikave që lidhen me kontrollin dhe ndalimin e aktiviteteve të paligjshme në PMLAT (sikurse është dhe shkarkimi i ujërave të ndotura drejtpërdrejt në liqen), grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga APR, nëse ka pasur inspektime të kryera nga APR (nga inspektorët që ka pasur në strukturë Drejtoria e PMLAT ose inspektorët në Drejtoritë e tjera të APR) dhe/ ose nga struktura të Bashkisë Tiranë në territorin e PMLAT lidhur me shkarkimin e ujërave të përdorura/ të ndotura. Nga APR është bërë me dije se APR nuk ushtron kompetenca inspektuese lidhur me shkarkimin e ujërave të përdorura/ të ndotura në liqen, pasi kjo kompetencë ushtrohet nga struktura të tjera të Bashkisë Tiranë apo struktura të tjera shtetërore të ngarkuara me ligj.

Grupi i auditimit ka kërkuar korrespondenca ndër vite të APR me institucionet përgjegjëse për kryerjen e inspektimeve lidhur me shkarkimet e ujërave të përdorura në liqen, por nga APR nuk është vënë në dispozicion dokumentacion i tillë, duke konfirmuar verbalisht se nuk ka pasur korrespondenca përpara shfaqjes së fenomenit të algave gjatë vitit 2024.

### **Mbi pastrimin ndër vite të Liqenit Artificial të Tiranës nga APR**

Lidhur me pastrimin e liqenit, ish-drejtori i PMLAT O. R. citon se Drejtoria e PMLAT ka në strukturën e saj rreth 66 punëtorë parqesh, disa prej tyre janë të angazhuar veçanërisht edhe në

<sup>18</sup> Sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. 2850/1 datë 20.01.2022 dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.1019, datë 25.03.2024

pastrimin e sipërfaqes ujore nga plastikat dhe mbetjet e hedhura në të apo bimësia vegjetuese në bregun e ujit. Mjetet e punës në dispozicion për të realizuar këto procese janë manuale dhe përfshijnë varkë lundruese dhe krehër metalikë për tërheqjen dhe largimin e mbetjeve dhe mbeturinave të tjera nga bregu dhe sipërfaqja e ujit. Sa i përket shpenzimeve të kryera ndër vite lidhur me pastrimin e basenit të Liqenit Artificial të Tiranës, Drejtori i Administrimit të PMLAT bën me dije se “*Agjencia e Parqeve dhe rekreacionit ka kryer shpenzime për pastrimin mekanik të sipërfaqes ujore nga mbeturinat, bimësia apo algat e krijuara. Ky pastrim ka përfshirë përdorimin e mjeteve të tilla si anije për mbledhjen e mbetjeve dhe pastrimin e sipërfaqes së ujit nga bimësia apo algat e krijuara*”. Grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi shpenzimet dhe procedurat e prokurimit të kryera nga APR në lidhje me furnizimin e shërbimit të pastrimit të Liqenit Artificial të Tiranës, ku nga APR është bërë me dije se nëpërmjet procedurave të prokurimit janë lidhur kontratat, si më poshtë:

**1. Marrëveshje kuadër me objekt “Pastrimi i baseneve të liqeneve në parqe”, për liqenin artificial të Tiranës dhe liqenin e Farkës për vitet 2021 – 2023;**

**2. Kontratë me objekt “Pastrimi i baseneve të liqeneve në parqe”, për liqenin artificial të Tiranës dhe liqenin e Farkës për vitin 2024.**

Nga specifikimet e bëra në kërkesë, rezulton se ky shërbim kërkohet të merret për basenet e të dy liqeneve nën administrimin e APR, liqeni artificial i Tiranës dhe liqeni i Farkës, si dhe se ky shërbim konsiston jo në masa të ndërmarra për ndotje të konstatuar, por një procedurë standarde që kryhet periodikisht një herë në vit, me qëllim pastrimin e sipërfaqes nga barishtet/kallamishtet. Grupi i auditimit nuk ka shqyrtuar dhe vlerësuar përputhshmërinë e procedurave të ndjekura nga APR në raport me legjislacionin e prokurimit publik për sigurimin e këtij shërbimi, pasi nuk ishte në fokusin e auditimit, që synon evidentimin e (i) masave parandaluese të institucioneve përgjegjëse për ndotjen e liqenit, (ii) shkaqeve të ndotjes, si dhe (iii) masave të marra për reduktimin deri në eliminim të pasojave të ndotjes së shfaqur në liqenin e Tiranës. Grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi aktivitetin pastrues, nëse janë përdorur substanca apo lëndë të ndryshme, dhe nga APR është bërë me dije se “*nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit nuk është përdorur asnjë substancë apo lëndë tjetër në ujërat e Liqenit, për shkak të mos dëmtimit të ekosistemit të tij, të ruajtjes së peshqve e zogjve që jetojnë aty, si dhe të parkut në tërësi*”... “*Për pastrimin e algave është përdorur dhe makineria e përfutur nga procedura “Pastrimi i baseneve të liqeneve në parqe”*”.

Për verifikimin e sa më sipër, grupi i auditimit ka shqyrtuar dhe vlerësuar dokumentacionin e marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit, nga ku u konstatua se:

**1. Marrëveshje kuadër nr. 281/13 prot., datë 06.05.2021 me objekt “Pastrimi i baseneve të liqeneve në parqe”, për liqenin artificial të Tiranës dhe liqenin e Farkës për vitet 2021 – 2023**

Ndërmjet APR dhe OE “N.” është lidhur Marrëveshja Kuadër nr. 281/13 prot., datë 06.05.2021, me afat 31.12.2023, me vlerë totale 18,000,000 lekë pa TVSh dhe 21,600,000 lekë me TVSh, si dhe kontrata nr. 281/14 prot., datë 06.05.2021, në pikën 21.3 të së cilës përcaktohet se Drejtoria e Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit (PMLAT) ngarkohet si strukturë përgjegjëse për ndjekjen e kontratës deri në përfundimin e saj.

Sa i përket Liqenit Artificial të Tiranës, marrja e shërbimit dhe likuidimet rezultojnë, si më poshtë:

**Për vitin 2021, nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 196, datë 17.06.2021, në vlerën prej 2,700,000 lekë, bazuar në faturën elektronike nr. 3/2021. Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhër nr. 281/16 prot., datë 06.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të APR, i përbërë nga R. A., E. B., R. B., punonjës të Drejtorisë së Administrimit PMLAT, ka hartuar procesverbalin e datës 28.05.2021 dhe situacionin nr. 1, të paprotokolluar, ku citohet se “*anëtarët e komisionit, pasi bënë verifikimet dhe kontrollin për sasinë dhe specifikimet e kërkuara arritën në përfundimin se sasia është realizuar sipas specifikimeve... liqeni artificial***

*i Tiranës është në sipërfaqen 450,000m<sup>2</sup>, pastrimi i sipërfaqes ujore është në vlerën totale 2,700,000 lekë”.*

**Për vitin 2022**, nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 324, datë 25.07.2022**, në vlerën prej **2,700,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 5/2022. Komisioni i marrjes në dorëzim, i ngritur me Urdhrin nr. 281/16 prot., datë 06.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të APR, ka hartuar procesverbalin e datës 05.07.2022 dhe situacionin nr. 4, të paprotokolluar, ku citohet se *“anëtarët e komisionit, pasi bënë verifikimet dhe kontrollin për sasinë dhe specifikimet e kërkuara arritën në përfundimin se sasia është realizuar sipas specifikimeve... liqeni artificial i Tiranës është në sipërfaqen 450,000m<sup>2</sup>, pastrimi i sipërfaqes ujore është në vlerën totale 2,700,000 lekë”.*

**Për vitin 2023**, nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 242, datë 12.07.2022**, në vlerën prej **2,700,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 2/2023. Komisioni i marrjes në dorëzim, i ngritur me Urdhrin nr. 250, datë 22.06.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të APR, i përbërë nga R. A., E. B., M. N., ka hartuar procesverbalin e datës 23.06.2022 dhe situacionin nr. 1 (mbajtur vetëm nga 1 anëtar i komisionit), të paprotokolluar, ku citohet se *“anëtarët e komisionit, pasi bënë verifikimet dhe kontrollin për sasinë dhe specifikimet e kërkuara arritën në përfundimin se sasia është realizuar sipas specifikimeve... liqeni artificial i Tiranës është në sipërfaqen 450,000m<sup>2</sup>, pastrimi i sipërfaqes ujore është në vlerën totale 2,700,000 lekë”.*

Në total, për 3 vjet në zbatim të kësaj kontrate, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka likuiduar vlerën prej **8,100,000 lekë**, për shërbimin e pastrimit të Liqenit Artificial të Tiranës. Në zbatim të kësaj kontrate, gjithashtu është likuiduar vlera prej 13,500,000 lekë, pra nga 4,500,000 lekë/ vit, për pastrimin e liqenit të Farkës, duke bashkëlidhur evidenca fotografike gjatë procesit të pastrimit me makinerinë e ujit.

**2. Kontratë nr. 1873/9 prot., datë 02.10.2024 me objekt “Pastrimi i baseneve të liqeneve në parqe”, për liqenin artificial të Tiranës dhe liqenin e Farkës për vitin 2024**

**Për vitin 2024**, nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 347, datë 14.11.2024**, në vlerën prej **2,565,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 14/2024. Komisioni i marrjes në dorëzim, i ngritur me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të APR nr. 748, datë 02.10.2024, i përbërë nga I. C., E. L., M. N., ka hartuar procesverbalin e datës 11.11.2024 dhe situacionin e datës 29.10.2024 – 11.11.2024, të paprotokolluar, ku citohet se *“anëtarët e komisionit, pasi bënë verifikimet dhe kontrollin për sasinë dhe specifikimet e kërkuara arritën në përfundimin se sasia është realizuar sipas specifikimeve... liqeni artificial i Tiranës është në sipërfaqen 450,000m<sup>2</sup>, pastrimi i sipërfaqes ujore është në vlerën totale 2,565,000 lekë”*, duke bashkëlidhur evidenca fotografike gjatë procesit të pastrimit me makinerinë e ujit.

Për sa më sipër, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se pastrimi i sipërfaqes së basenit të liqenit artificial të Tiranës është kryer nëpërmjet mjeteve të posaçme lundruese për pastrimin e sipërfaqeve ujore nga mbeturinat dhe bimësia, dhe nuk rezulton që APR dhe/ose kontraktori që ka ofruar shërbimin e pastrimit të sipërfaqes së basenit të liqenit artificial të Tiranës të kenë përdorur lëndë kimike apo substanca që të kenë ndikuar në ndotjen e mjedisit.

### **2.3 Mbi masat e marra për përmirësimin e situatës së shfaqur në basenin e Liqenit Artificial të Tiranës dhe menaxhimi i qëndrueshëm.**

*Në përballje me ndotjen e shfaqur në Liqenin Artificial të Tiranës, reagimi institucional ka qenë i fragmentuar, duke u aktivizuar vetëm pas shfaqjes së ndotjes. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit (APR) nisi korrespondencat me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore dhe lokale, vetëm pasi ndotja ishte bërë e dukshme. Analizat laboratorike të kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) konfirmuan prani të lartë të ndotësve dhe të shkarkimeve të ujërave të patrajtuar, ndërkohë që Agjencia Rajonale Mjedisore (ARM) Tiranë nuk kreu inspektime, duke konkluduar se subjektet e evidentuara nuk dispononin leje mjedisore e për rrjedhojë ishin jashtë juridiksionit inspektues të ARM-së, çka u referua më pas te Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT). IKMT konstatoi se ndotja vinte nga kanalet e*

*ujërave të bardha që përziheshin me ujëra të ndotur urban dhe përfundonin të patrajtuara në liqen, duke kërkuar nga Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (UKT) marrjen e masave për ndërprerjen e menjëhershme të përzierjes së ujërave të bardha (të shiut) me ujëra të ndotura. UKT nuk ka disponon hartë të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (të shiut), duke pamundësuar gjurmimin e burimit të ndotjes dhe marrjen e masave parandaluese efektive nga institucionet përgjegjëse për kryerjen e inspektimeve. Kjo situatë tregon qartësisht mungesën e koordinimit dhe të veprimeve efektive nga institucionet përgjegjëse të qeverisjes lokale dhe qendrore.*

Pas shfaqjes së ndotjes në basenin e Liqenit të Tiranës, APR-ja ka nisur korrespondencat me institucione të tjera të qeverisjes qendrore dhe lokale, me qëllim marrjen e masave për zgjidhjen e situatës, konkretisht:

Nëpërmjet korrespondencës elektronike, në datën 16.10.2024, Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit në APR i drejtohet AKM, duke kërkuar mundësinë e mbështetjes me marrjen e mostrave, për të bërë të mundur njohjen e nivelit të ndotjes dhe vlerësimin e shkaqeve që kanë sjellë në këtë cilësi ujërat e liqenit. Në datën 18.10.2024, përgjegjësja e laboratorit në AKM i drejtohet elektronikisht nëpërmjet e-mail APR-së, duke bërë me dije se “nga AKM u realizua kampionimi në dy stacione në liqen në datën 16.10.2024”, duke bashkëngjitur raport-analizat për kampionet e marra dhe vlerësimin e rezultateve.

Bashkëlidhur kësaj korrespondence janë vënë në dispozicion analizat, si më poshtë:

- Raport-analiza me nr. serial 40, data e marrjes së mostrës 16.10.2024, data e kryerjes së analizës 16.10.2024, me përshkrim “Mostër ujë sipërfaqësor, te pika e shkarkimit, Diga e Liqenit Artificial, Tiranë”, përzgjedhur nga S. P. dhe I. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.

- Raport-analiza me nr. serial 41, data e marrjes së mostrës 16.10.2024, data e kryerjes së analizës 16.10.2024, me përshkrim “Mostër ujë sipërfaqësor, te Moli “Henry Durant”, Liqeni Artificial, Tiranë”, përzgjedhur nga S. P. dhe I. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave.

- “Informacion mbi vlerësimin e rezultateve të Raport-Analizës me nr. serial 40 dhe 41”, nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit V. P., ku citohet, si më poshtë:

*“Vlerësimi i rezultateve për parametrat e analizuar është realizuar në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EC”.  
Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 40*

*“Është vlerësuar se ka përmbajtje të lëndës pezull ku nga inspektimi vizual në terren vjen si pasojë e algave të zhvilluara në sipërfaqe në vendin e kampionimit. Ky fenomen ka ndikuar edhe në vlerat e larta të Nevojës Kimike për Oksigjen, pasi algat izolojnë sipërfaqen e ujit dhe kjo sjell mungesë oksigjenimi në ujërat e liqenit.*

**Konkluzion**<sup>19</sup>: *Në analizën e kryer vlerësohet se nuk ka ndotje dhe vlerat e larta të NKO dhe përmbajtja e fosforit total vijnë si pasojë e fenomenit të zhvillimit të algave, duke e klasifikuar kampionin në cilësi mezotrofrike me tendencë eutrofie”.*

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 41

*“Është vlerësuar se ka përmbajtje të lëndës pezull ku nga inspektimi vizual në terren vjen si pasojë e algave të zhvilluara në sipërfaqe në vendin e kampionimit. Ky fenomen ka ndikuar në vlerat e larta të Nevojës Kimike për Oksigjen, pasi algat izolojnë sipërfaqen e ujit dhe kjo sjell mungesë oksigjenimi në ujërat e liqenit.*

**Konkluzion**: *Në analizën e kryer vlerësohet se nuk ka ndotje dhe vlerat e larta të NKO vijnë si pasojë e fenomenit të zhvillimit të algave, duke e klasifikuar kampionin në cilësi mezotrofrike”.*

---

<sup>19</sup> *Shënim për qartësim*: Këtu dhe në vijim të trajtimit të kësaj pike “Konkluzion” i referohet konkluzionit të bërë nga AKM në Raportet e Analizave të kryera.

Nëpërmjet e-mail të datës 16.10.2024, APR-ja i është drejtuar **Fakultetit të Shkencave të Natyrës**, duke kërkuar kryerjen e analizave të ujit të liqenit të Tiranës. Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion shkresa e datës 18.10.2024, drejtuar Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, e sigluar nga Prof. A. M.. Në këtë shkresë janë paraqitur *“mendime mbi dy analizat e kryera nga AKM”*, ku citohet se *“pasoja nuk mund të jetë asnjëherë ndotës, ndotës i një dukurie është gjithmonë shkaku, dhe në këtë rast me siguri janë vlerat e larta të fosforit. Janë edhe nitratet, por nuk po merremi me to, pasi fosfori është faktor kufizues (nxitës)”*...*“kjo dukuri (ky lulëzim algash) në Liqenin artificial të Tiranës është pasojë dhe sinjal i ngarkesës relativisht të lartë (ndotjes) me lëndë ushqyese (azot dhe sidomos fosfor) që kanë shumë mundësi të vijnë nga ujërat e patrajuara urbane, por jo vetëm, të cilat mund të grumbullohen në mënyrë të vazhdueshme në këtë liqen... Mbetet e ngutshme për Bashkinë Tiranë grumbullimi dhe largimi i shkarkimeve nga liqeni! Por sidomos mbetet sfidë grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza për gjithë pellgun e Tiranës, si domosdoshmëri për cilësinë e jetës për njeriun dhe për gjithë botën e gjallë”*.

Nëpërmjet shkresës nr. 2164 prot., datë 17.10.2024, APR-ja i drejtohet **Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK)**, si institucioni i qeverisjes qendrore që mbulon sektorin e kanalizimeve, duke kërkuar informacion nëse subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në territorin e PMLAT-së shkarkojnë ujëra të pa trajtuara në liqenin e Tiranës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, AKUK nuk rezulton të ketë kthyer përgjigje.

Nëpërmjet shkresës me nr. 2206 prot., datë 29.10.2024, APR-ja i drejtohet **Agjencisë Kombëtare të Mjedisit**, duke kërkuar inspektimin në territorin e Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, cituar *“për shkak të rëndësisë së PMLAT si një destinacion rekreativ i qytetit, është e nevojshme të ndërmerren masa për mbrojtjen e cilësisë së ujit dhe mjedisit përreth, për të shmangur ndotjet e mundshme nga shkarkimet e paautorizuara pranë ujërave të liqenit apo të mbetjeve që dëmtojnë ekosistemin”*. Nëpërmjet kësaj shkresë, APR-ja kërkon kryerjen e inspektimeve të subjekteve tregtare, duke u siguruar që aktivitetet tregtare në këtë zonë të jenë në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe marrjen e mostrave dhe analizimin e shtatë pikave të identifikuara, si mundësi ndotjeje për Liqenin Artificial të Tiranës, duke përcaktuar gjithashtu vendndodhjet me koordinata. AKM-ja, në datën 07.12.2024, ka kryer analizat përkatëse, në raportet e të cilave ka rezultuar me përmbajtje mbi normë të nitrateve dhe nevojës kimike për oksigjen. Konkretisht:

Drejtori i Përgjithshëm i ARM Tiranë, E. A. ka dërguar shkresën nr. 1008 prot., datë 06.11.2024, administruar në APR me nr. 2206/1 prot., datë 11.11.2024, me objekt *“Informacion mbi cilësinë e ujërave të Liqenit Artificial të Tiranës”*, ku janë bashkëlidhur Raport Analizat si më poshtë:

- Raport-analiza me nr. serial 45, data e marrjes së mostrës 28.10.2024, data e kryerjes së analizës 29.10.2024, me përshkrim *“Mostër ujë shkarkimi, kolektori pranë Kalçeto P..., Liqeni Artificial, Tiranë”*, zgjedhur nga B. S. me detyrë Specialist në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis.

- Raport-analiza me nr. serial 46, data e marrjes së mostrës 28.10.2024, data e kryerjes së analizës 29.10.2024, me përshkrim *“Mostër ujë shkarkimi, kolektori pranë fushës së basketbollit, Liqeni Artificial, Tiranë”*, zgjedhur nga B. S. me detyrë Specialist në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis.

- *“Informacion mbi vlerësimin e rezultateve të Raport Analizës me nr. serial 45 dhe 46”*, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë N. P. dhe Përgjegjësi i Sektorit V. P., ku citohet, si më poshtë:

*“Kampionët e realizuar janë kryer për të gjithë parametrat fiziko-kimikë, pasi në këto kolektorë ujërat e mbledhur janë ujëra të bardha, ku përmbajtja e këtyre parametrave duhet të jetë në vlera të ulëta. Nuk është bërë krahasim, pasi nuk kemi norma për këtë matricë”*.

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 45

*“Është vlerësuar se ka përmbajtje të amoniakut, nitrateve dhe nevoja kimike për oksigjen është e lartë, duke dëshmuar për një ndotje të shkarkimeve urbane të patrajuara në këtë kolektor. Si konkluzion, në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje të cilat mendohet që vijnë nga shkarkimet e ujërave të patrajuara prej aktiviteteve përreth”.*

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 46

*“Është vlerësuar se ka përmbajtje të amoniakut, nitrateve dhe nevoja kimike për oksigjen është e lartë, duke dëshmuar për një ndotje të shkarkimeve urbane të patrajuara në këtë kolektor. Si konkluzion, në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje të cilat mendohet që vijnë nga shkarkimet e ujërave të patrajuara prej aktiviteteve përreth”.*

Në këtë shkresë, Drejtori i ARM-së Tiranë citon se *“Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërat) në ARM Tiranë, me datë 28 tetor, ka qenë pjesë e një grup kontrolli ndërinstitucional, në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, UK Tiranë 1, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes, Rrugë, Ndriçim, Sinjalistikë (DNP 2), AMBU, ARRSH dhe AKM, ku është zhvilluar kontroll gjatë bregut të Liqenit Artificial të Tiranës. Gjatë kontrollit u evidentua se në 6 nga 8 pikat e shkarkimit të ujërave të bardha kishte rrjedhje... Analizimi i mostrave të marra rezulton mbi normat e lejuara. Lutemi të merrni masa për përmirësimin e situatës në të gjitha pikat e shkarkimeve në liqen”.*

Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion nga AKM të praktikës së kontrollit ndërinstitucional të datës 28.06.2024, të cituar në shkresë, sa i përket përfshirjes së AKM në këtë proces, që nga autorizimi për pjesëmarrje e deri te relacionet përmbledhëse ku të paraqiten konstatimet e përfaqësuesve të AKM në kontroll dhe informacioni drejtuar titullarit/autorizuesit, por kjo praktikë nuk rezulton të jetë dokumentuar nga AKM-ja. E njëjta përgjigje u konfirmua edhe nga institucionet e tjera objekt auditimi, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, UKT dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes, Rrugë, Ndriçim, Sinjalistikë (DNP 2), nga të cilët u pohua se të gjitha strukturat e mësipërme kanë dërguar përfaqësuesit e tyre për të qenë pjesë e një grup kontrolli ndërinstitucional, por asnjë proces/ aktivitet i kryer në këtë verifikim nuk është dokumentuar.

Nëpërmjet shkresës nr. 2207 prot., datë 29.10.2024, APR-ja i është drejtuar **Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore**, duke kërkuar ndërmarrjen e një inspektimi të detajuar mbi situatën aktuale. Nëpërmjet shkresës nr. 1593/1 prot., datë 01.11.2024, AMBU-ja i drejtohet APR-së, për dijeni AKM-së, ku konfirmon nevojën për bashkëpunim *me qëllim identifikimin e burimit të ndotjes, gjetjen e mjeteve për ndalimin e saj, si edhe gjetjen e mundësive për të përmirësuar gjendjen e këtij trupi ujqor si dhe vlerëson që në këtë proces do të duhet të përfshihet dhe AKM”.*

Nëpërmjet shkresës me nr. 2208 prot., datë 29.10.2024, APR-ja i është drejtuar **Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT)**, duke kërkuar kryerjen e inspektimit të detajuar dhe marrjen e masave të nevojshme në lidhje me subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike, për të verifikuar nëse shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajuara në ujërat e Liqenit Artificial të Tiranës. Nga APR-ja nuk është vënë në dispozicion përgjigja e kthyer nga IKMT, lidhur me sa më sipër.

Nëpërmjet shkresës nr. 1350/4 prot., datë 11.03.2025, KLSH-ja ka kërkuar informacion nga IKMT lidhur me hapat e ndërmarrë për ndotjen në liqenin artificial të Tiranës. IKMT-ja ka kthyer përgjigje, administruar në KLSH me nr. 1350/6 prot., datë 21.03.2025, duke vënë në dispozicion ndër të tjera korrespondencat, si më poshtë:

- Memo nr. 6574/1 prot., datë 31.10.2024, nëpërmjet së cilës Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave pranë IKMT-së bën me dije Kryeinspektorin e IKMT-së mbi verifikimin e kryer në liqenin artificial të Tiranës, ku ndër të tjera citohet: *“Duke verifikuar me sy të lirë liqeni në afërsi të brigjeve dhe në pjesët e cekëta ujore u konstatua një shtresë që pluskonte mbi ujë.*

*Sipas njoftimit nga Drejtori i PMLAT bëhet fjalë për një bakter me emër Cianobakter. Një nga arsyet kryesore të formimit dhe përqendrimit të këtij bakteri është shkarkimi i ujërave të ndotur (të zeza), mosqarkullimi i ujit, temperatura e lartë, etj. Nga verifikimi i kryer u konstatuan 8 pika aktive ku kryhej shkarkimi i ujërave në liqen. Këto pika ishin kryesisht dalje të kanalizimeve të ujërave të bardha që vijnë nga kolektorët për mbledhjen e ujërave sipërfaqësore të rrugës (autostrada Unaza e Madhe)... U rakordua që nga ana e APR-së të kërkohej pranë UKT-së prania e specialistëve, si dhe hartat përkatëse me kanalizimet të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në shkarkimet sipërfaqësore të Liqenit”.*

- Shkresa e Kryeinspektorit të IKMT-së nr. 316/2 prot., datë 16.01.2025, drejtuar UKT-së, për dijeni APR-së dhe ARM-së Tiranë, ku ndër të tjera është citohet se: *“Pas verifikimeve në terren, u konstatuan se shkarkimet që ndodhin në liqen, në pikat ku janë konstatuar ndotje: vijnë si rrjedhojë e përzjerjes së ujërave të bardha me ujërat e ndotur urban. Këto janë rrjedha të lira nga tobinat të cilat janë të përziera me ujërat e ndotur që vijnë nga pjesa e urbanizuar e zonës, përkatësisht zona e Liqenit të Thatë, dhe shkarkohen në liqenin artificial të Tiranës, duke shkaktuar ndotjen e tij sipas raportimit të fletë-analizave... Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj marrjen e masave të menjëhershme për diferencimin e ujërave të bardha nga ato të ndotura, si dhe mbylljen/ izolimin e pikave që shkarkojnë ujëra të ndotura”.*

Nëpërmjet shkresës nr. 2220 prot., datë 30.10.2024, APR-ja i është drejtuar **Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a (UKT)**, duke kërkuar bashkëpunim për kryerjen e inspektimit të rrjetit të shkarkimit të ujërave të ndotura që mund të rrjedhin në të gjithë zonën e Parkut të Madh të Liqenit të Tiranës, për të siguruar nëse ka rrjedhje të patrajtuara në këtë liqen. Nëpërmjet shkresës nr. K-2642/1 prot., datë 06.11.2024, UKT-ja bën me dije se *“Nga ana e UKT sh.a në vitin 2023 është kryer investim në sistemin e rrjetit të Ujërave të Ndotur me ngritje mekanike nëpërmjet një sistemi pompash. Ky investim përfshin zonën përreth Liqenit Artificial me konkretisht bllokun e banimit që kufizohet nga Rrugët “Liqeni i thatë”, “Hiqmet Buzi”, “Adem Sina” etj. duke i dhënë një zgjidhje definitive rrjetit i cili mungonte në këtë zonë, por gjithashtu disiplinimit dhe sistemit të ndonjë shkarkimi të mundshëm në mënyrë të paligjshme në Liqen. Nga ana jonë në bashkëpunim me organet që mbulojnë dhe cilësinë e LA do të merren masa për kontrollë për sa i përket shkarkimit dhe largimit të ujërave të ndotur në zonën përreth liqenit”.* Sa më sipër, UKT nuk ka kthyer një përgjigje të mirëfilltë lidhur me kërkesën për bashkëpunim dhe nuk rezultoi të jetë kryer asnjë kontroll/ inspektim vijues nga UKT, lidhur me situatën e krijuar.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit memon me nr. 12534 prot., datë 27.11.2024, nga Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave, drejtuar Sektorit të Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis pranë AKM, për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm të AKM, me objekt *“Informacion lidhur me Raport analizat nr. 57-63”*, ku bëhet me dije se u kampionua në 7 pika dhe mostrat u dorëzuar në laborator më datë 18.11.2024, si më poshtë:

- Raport-analiza me nr. serial 57, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim *“Mostër ujë sipërfaqësor, 200m përpara Kompleksit F..., Liqeni Artificial, Tiranë”*, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;
- Raport-analiza me nr. serial 58, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim *“Mostër ujë sipërfaqësor, 200m përpara Kompleksit F..., Liqeni Artificial, Tiranë”*, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;
- Raport-analiza me nr. serial 59, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim *“Mostër ujë sipërfaqësor, 150m përpara Kompleksit F...,*

*Liqeni Artificial, Tiranë*”, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;

- Raport-analiza me nr. serial 60, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim “*Mostër ujë sipërfaqësor, 750m pas Kompleksit F..., Liqeni Artificial, Tiranë*”, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;

- Raport-analiza me nr. serial 61, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim “*Mostër ujë sipërfaqësor, 30m larg Kalçeto “P...”, pranë Liqenit Artificial, Tiranë*”, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;

- Raport-analiza me nr. serial 62, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim “*Mostër ujë sipërfaqësor, Pista e biçikletave, Liqeni Artificial, Tiranë*”, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;

- Raport-analiza me nr. serial 63, data e marrjes së mostrës 18.11.2024, data e kryerjes së analizës 19.11.2024, me përshkrim “*Mostër ujë sipërfaqësor, 30m para L... C..., Liqeni Artificial, Tiranë*”, zgjedhur nga B. S. dhe B. P., me detyrë Specialistë në Sektorin e Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis;

- “*Informacion mbi vlerësimin e rezultateve të Raport analizave me nr. serial 57-63*”, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë N. P. dhe Përgjegjësi i Sektorit V. P., ku citohet, si më poshtë:

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 57

*“Është vlerësuar se kemi tejkalim të normave për parametrat Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total, duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi eutrofike, tregues për një shkallë ndotje të lartë si pasojë e shkarkimeve të patrajuara në ujërat e liqenit nga aktiviteti përreth.*

**Konkluzion:** *Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje organike e cila ka sjellë eutrofizimin e ujërave të liqenit”.*

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 58

*“Është vlerësuar se kemi tejkalim të normave për parametrat Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total, duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi eutrofike, tregues për një shkallë ndotje të lartë si pasojë e shkarkimeve të patrajuara në ujërat e liqenit nga aktiviteti përreth.*

**Konkluzion:** *Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje organike e cila ka sjellë eutrofizimin e ujërave të liqenit”.*

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 59

*“Është vlerësuar se kemi tejkalim të normave për parametrat Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total, duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi eutrofike, tregues për një shkallë ndotje të lartë si pasojë e shkarkimeve të patrajuara në ujërat e liqenit nga aktiviteti përreth.*

**Konkluzion:** *Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje organike e cila ka sjellë eutrofizimin e ujërave të liqenit”.*

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 60

*“Është vlerësuar se kemi tejkalim të normave për parametrat Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total, duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi eutrofike, tregues për një shkallë ndotje të lartë si pasojë e shkarkimeve të patrajuara në ujërat e liqenit nga aktiviteti përreth.*

**Konkluzion:** *Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje organike e cila ka sjellë eutrofizimin e ujërave të liqenit”.*

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 61

“Është vlerësuar se kemi përmbajtje të parametrave Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total në klasën kufi të pranimit të cilësisë së ujërave Cilësi mezotrofike (ndotje e moderuar), duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi mezotrofike.

**Konkluzion:** Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje të moderuar”.

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 62

“Është vlerësuar se kemi përmbajtje të parametrave Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total në klasën kufi të pranimit të cilësisë së ujërave Cilësi mezotrofike (ndotje e moderuar), duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi mezotrofike.

**Konkluzion:** Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje të moderuar”.

Interpretimi i Raport analizës me nr. serial 63

“Është vlerësuar se kemi tejkalim të normave për parametrat Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total, duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi eutrofike, tregues për një shkallë ndotje të lartë si pasojë e shkarkimeve të patrajuara në ujërat e liqenit nga aktiviteti përreth.

**Konkluzion:** Në analizën e kryer vlerësohet se ka ndotje organike e cila ka sjellë eutrofizimin e ujërave të liqenit”.

Nga të dhënat e administruara nga AKM, mostrat janë marrë në pikat në hartë, si më poshtë:



**Burimi:** Koordinatat marrë nga AKM/përcaktuar në hartë nga Grupi i Auditimit

Nëpërmjet shkresës nr. 12925 prot., datë 10.12.2024 Drejtorja e Menaxhimit të të dhënave Mjedisore, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit pranë AKM i drejtohet ARM-së së Tiranës, ku janë paraqitur Raport analizat nr. 57-63 (të sipërlistuara), duke përcaktuar vendet ku janë marrë mostrat, si dhe duke cituar “Sa më sipër është vlerësuar se kemi tejkalim të normave të parametrave Nevoja Biokimike për Oksigjen, Nevoja Kimike për Oksigjen, përmbajtja e fosforit total duke i klasifikuar ujërat e këtij stacioni të kampionuar me cilësi eutrofike, pra ka ndotje organike e cila sjell eutrofizimin e ujërave”.

Nëpërmjet shkresës nr. 356/1 prot., datë 11.12.2024, Drejtori i ARM-së Tiranë E. A. i drejtohet IKMT-së, APR-së dhe AKM-së, ku i bën me dije se ne 7 pikat e shkarkimit të ujërave të bardha kishte rrjedhje dhe se analizat e mostrave të marra rezultojnë mbi normat e lejuara, duke bashkëngjitur dhe Raport analizat. Në shkresë citohet se “...ju bëjmë me dije se nga evidentimi në terren subjektet e kontrolluara nuk kanë leje mjedisi dhe si pasojë nuk bëjnë pjesë e juridiksionit inspektues të ARM-së ku kontrollohen kushtet e lejes mjedisore. Gjatë kontrollit u

evidentua se në 7 pikat e shkarkimit të ujërave të bardha kishte rrjedhje. Nga laboratorit i AKM-së u morën mostra për analizimin e parametrave të ujit dhe rezultati i tyre ndodhet bashkëlidhur, analizimi i mostrave të marra rezulton mbi normat e lejuara”. Drejtori i ARM Tirana nuk e ka dërguar këtë shkresë edhe te Inspektorati Qendror, në kundërshtim me pikën 3 të Urdhrit nr. 29, datë 30.08.2023. Grupi i auditimit ka kërkuar nga AKM vënien në dispozicion të:

1. Praktikës së plotë në vijim të ngritjes së grupit të punës me nr. 356 prot., datë 11.11.2024 (të cituar në shkresën e ARM Tiranë drejtuar IKMT-së, APR-së dhe AKM-së);
2. Identifikimit me koordinata dhe mënyrës si u përzgjedhën 7 pikat ku janë marrë mostrat;
3. Procesverbalet dhe dokumentacioni shoqërues i procesit të marrjes së mostrave;
4. Të gjitha procedurat e inspektimit të kryera nga AKM pas rezultatit të analizave nr. 57-63;
5. Përcaktimin dhe listimin e të gjithë subjekteve që janë identifikuar/ evidentuar për secilës prej mostrave të marra, për të cilët është konkluduar se “subjektet nuk kanë leje mjedisi e rrjedhimisht nuk janë nën juridiksionin e ARM”.

Nga AKM dhe ARM Tirana nuk është kthyer përgjigje dhe nuk është vënë në dispozicion dokumentacion mbi sa më sipër, por nga Drejtori i ARM Tiranë E. A. janë rivënë në dispozicion shkresat:

- Nr. 1008 prot., datë 07.11.2024, drejtuar Bashkisë Tiranë dhe institucioneve të varësisë, AMBU-së, ARRSH-së, AKM-së, duke cituar se “në 6 nga 8 pikat e shkarkimit të ujërave të bardha kishte rrjedhje... Analizimi i mostrave të marra rezulton mbi normat e lejuara. Lutemi të merrni masa për përmirësimin e situatës në të gjitha pikat e shkarkimeve në liqen”;
- Nr. 356/1 prot., datë 11.12.2024, drejtuar IKMT-së, APR-së dhe AKM-së, trajtuar më sipër, të cilat nuk janë ato të kërkuarat.

Pavarësisht se mostrat ku është konstatuar se ka shkarkime të ujërave të ndotura janë marrë në pikat e shkarkimit të ujërave të bardha, që lidhin liqenin artificial të Tiranës me anën tjetër përtej autostradës (nga kodra e liqenit), është e paqartë se cilëve subjekte u referohet Drejtori i ARM Tirana kur citon në shkresën nr. 356/1 prot., datë 11.12.2024, se “subjektet nuk janë të pajisur me leje mjedisore e rrjedhimisht nuk janë subjekt i inspektimeve që kryen ARM”.

Nëpërmjet e-mail të datës 07.03.2025, me qëllim pasqyrimin e plotë të aktivitetit institucional mbi këtë problematikë, grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi hapat e mëtejshëm të ndërmarrë nga AKM dhe ARM Tirana për verifikimin e shkaqeve të ndotjes dhe identifikimin e ndotësve specifikë, inspektime vijuese dhe masat e marra me qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, si dhe korrespondenca vijuese me inspektorate të tjerë në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional të AKM në fushën e mbrojtjes së mjedisit, por nga AKM nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion/ dokumentacion shtesë, për të vërtetuar se janë marrë masa vijuese për përmirësimin e situatës mjedisore në liqenin artificial të Tiranës.

Përveç korrespondencave të mësipërme, për përmirësimin e situatës së krijuar, APR-ja ka kryer procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për blerjen e rasatit të peshkut”. Drejtori i Drejtorisë së Administrimit të PMLAT O. R., nëpërmjet shkresës nr. 2334 prot., datë 20.11.2024, ka kërkuar blerjen dhe depozitimin në liqen të rasatit të peshkut, duke përdorur procedurën e blerjes së mallrave me vlerë nën 100,000 lekë, duke cituar se “për shkak të pasurimit të faunës, në funksion të përmirësimit të ekosistemit ujor, kërkojmë të realizohet blerja dhe depozitimi në liqen i 10,000 copë rasat peshku”. Nga specifikimet në kërkesë, konstatohet se kemi të bëjmë me Rasatë Amuri. Nëpërmjet procesverbalit të datës 04.12.2024, i paprotokolluar, Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga A. Z., A. M., B. H., ka marrë në dorëzim mallin, duke cituar se “pasi konstatuan sasinë dhe llojin e peshkut të nevojshëm për objektin e kërkuar, doli në konkluzionin se rasati është në sasinë dhe llojin e kërkuar”. Nga dokumentet e vena në dispozicion, nuk rezulton që kërkesa për këtë procedurë (blerje e vogël), të jetë mbështetur në një relacion teknik të kryer nga specialistë të fushës, për të vlerësuar

përshtatshmërinë e hedhjes së rasateve për përmirësimin e situatës në lidhje me problematikën e algave të shfaqura.

Nga një verifikim rutinë në terren i grupit të auditimit në datën 06.01.2025, në brigjet e liqenit u konstatuan tufa peshqish të mbledhur në sipërfaqe, çka mund të jetë si pasojë e mungesës së oksigjenit brenda trupit uJOR të liqenit të Tiranës, pasqyruar në fotot e mëposhtme:

*Foto 10-11: Foto nga verifikimi në terren i grupit të auditimit në datë 06.01.2025. Peshqit në sipërfaqe, pranë molit "Henry Durant" te diga e Liqenit Artificial të Tiranës*



**Burimi:** Grupi i auditimit

Nëpërmjet shkresës nr. 96 prot., datë 14.01.2025, APR-ja i është drejtuar **Institutit të Shëndetit Publik (ISHP)** për kryerjen e analizave mikrobiologjike. Nëpërmjet shkresës me nr. 99/1 prot., datë 27.01.202, ISHP i kthen përgjigje APR-së se nuk ka kompetencë për monitorimin e ujërave sipërfaqësore.

Nëpërmjet shkresës nr. 97 prot., datë 14.01.2025, APR-ja i drejtohet **Policisë Bashkiake**, për dijëni **Bashkisë Tiranë**, duke kërkuar monitorimin e vazhdueshëm të bregut të liqenit përgjatë gjithë gjatësisë së tij.

#### **Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në konkluzionin se:**

- Bashkia Tiranë, në rolin e administratorit të PMLAT, nuk ka hartuar një plan menaxhimi për Liqenin Artificial të Tiranës, që të përcaktojë ndarjen e detyrave, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore, për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit.
- Liqeni Artificial i Tiranës nuk disponon një sistem qarkullues të ujit, por furnizohet vetëm nga prurjet natyrore (ujërat e shirave).
- Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë (APR, UKT, DPN2) nuk disponojnë një hartë ose plan të shtrirjes së kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në liqen. Nga auditimi rezulton se tombinat e këtyre kanaleve janë të dëmtuara dhe përmes tyre ndodhin shkarkime të ujërave të ndotura.
- Brenda territorit të PMLAT, bazuar në kontratat me UKT, operojnë 10 subjekte private. Ndërkohë, sipas APR, operojnë 14 subjekte. Kjo tregon mungesë koherence ndërinstitucionale mbi numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë zonë. Verifikimi në terren nga grupi i auditimit evidentoi më shumë se 14 subjekte aktive, të cilat, në mungesë të rrjetit të kanalizimeve, operojnë me zgjidhje individuale (gropa septike), që nuk monitorohen nga asnjë institucion shtetëror.
- Territori i PMLAT nuk është i mbuluar nga rrjeti i kanalizimeve, ndaj subjektet që operojnë në këtë zonë përdorin zgjidhje individuale për largimin e ujërave të ndotura urbane (p.sh. gropa septike). As UKT dhe as institucionet e tjera të varësisë së Bashkisë Tiranë nuk disponojnë informacion mbi mënyrën se si këto subjekte menaxhojnë ujërat e ndotura.

- Asnjë nga institucionet e varësisë së Bashkisë Tiranë, përfshirë APR-në që administron PMLAT, nuk disponon informacion mbi vendndodhjen dhe gjendjen teknike të gropave septike.
- Në lidhje me ndotjen e konstatuar në liqen, nuk janë kryer asnjëherë analiza mikrobiologjike, por vetëm analiza fiziko-kimike.
- Edhe pse strukturat shtetërore kanë evidentuar që në tetor 2024 (rreth 6 muaj para auditimit) shkarkime të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara në liqen, nuk janë marrë masa konkrete për (i) identifikimin e shkaqeve dhe përgjegjësve të ndotjes, (ii) ndërprerjen e menjëhershme të burimeve të ndotjes dhe (iii) përmirësimin e situatës mjedisore. Bashkëpunimi ndërinstytucional ka qenë i munguar, fakt i pranuar edhe nga vetë strukturat e APR gjatë auditimit.
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, si strukturë e varësisë së Bashkisë Tiranë që menaxhon parkun, nuk disponon një njësi funksionale për inspektim, kontroll ose evidentim të veprimtarive të jashtëligjshme brenda territorit të PMLAT.
- APR-ja nuk ka evidentuar asnjëherë problematika që mund të shkaktonin ndotje dhe nuk ka kërkuar bashkëpunim me institucionet e qeverisjes qendrore për analizimin e cilësisë së ujit, përpara se ndotja të bëhej e dukshme dhe të merrte vëmendje mediatike.
- Gjatë periudhës së auditimit 2021–2024, APR ka shpenzuar 10,665,000 lekë për pastrimin e basenit të liqenit artificial të Tiranës. Ky pastrim ka qenë vetëm mekanik (heqje plastikash, bimësie etj.), dhe nuk ka pasur në fokus eliminimin ose reduktimin e ndotësve që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujit.
- APR ka realizuar një blerje mallrash me vlerë nën 100,000 lekë për 10,000 rasat peshku, duke pretenduar përmirësim të ekosistemit ujor. Megjithatë, në dokumentacion nuk ishte përfshirë ndonjë relacion teknik nga specialistë të fushës. Gjatë një verifikimi në terren më 06.01.2025, një muaj pas hedhjes së rasatit (bazuar në PV të 04.12.2024), u konstatuan tufa peshqish në sipërfaqe, gjë që mund të jetë pasojë e mungesës së oksigjenit në ujin e liqenit.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka përmblusur detyrimin për monitorimin e treguesve të cilësisë së ujit në liqenin artificial të Tiranës, megjithëse ky është pjesë e rrejtës kombëtar të monitorimit në kuadër të Programeve Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.

*Pas përfundimit të afatit 30-ditor nga dërgimi i Projekt Raportit të Auditimit, subjektet e audituara nuk kanë paraqitur observacione mbi sa trajtuar në drejtimet përkatëse nga grupi i auditimit.*

#### **IV. REKOMANDIME:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektivat e mbrojtjes së mjedisit përfshihen parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit, mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit, apo dhe mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut. Bazuar në ligjin për vetëqeverisjen vendore neni 26, bashkitë kanë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së mjedisit në lidhje me sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ujit nga ndotja. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tiranë nuk ka hartuar një plan menaxhimi dhe zhvillimi të qëndrueshëm mjedisor, sa i përket Parkut të Liqenit Artificial të Tiranës ku përfshihet edhe baseni i liqenit. Mungesa e një plani menaxhimi me përcaktime të qarta të detyrave dhe përgjegjësive të secilit prej institucioneve të varësisë të Bashkisë Tiranë, si dhe mungesa e përfshirjes së institucioneve të qeverisjes qendrore sipas nevojave, nuk ka garantuar dhe nuk ka mundësuar, sigurimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ujit nga ndotja në nivel vendor.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Tiranë të marrë masa për hartimin e një plani menaxhimi për Liqenin Artificial të Tiranës, duke përcaktuar qartazi përgjegjësitë e institucioneve të saj të varësisë. Gjithashtu, në të, të parashikojë dhe nevojën e bashkëpunimit me strukturat e qeverisjes qendrore, lidhur me administrimin, mirëmbajtjen, pastrimin e basenit të Liqenit të Tiranës, si dhe inspektimin dhe evidentimin e aktiviteteve të paligjshme lidhur me shkarkimet e drejtpërdrejta në Liqen. Plani të përfshijë kryerjen e mirëmbajtjes teknike të strukturave specifike, si kanalet e ujërave të shiut dhe portën e digës, me qëllim për të garantuar mbrojtjen afatgjatë të mjedisit, biodiversitetit dhe cilësisë së ujit në Parku i Madh i Liqenit Artificial të Tiranës.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është përcaktuar për t'u monitoruar për çdo vit, Liqeni Artificial i Tiranës. Në këtë program përcaktohen gjithashtu treguesit që duhen analizuar gjatë këtyre monitorimeve (përfshirë treguesit fiziko-kimikë, mikrobiologjikë, pesticidet, metalet e rënda, etj.) si dhe frekuenca përkatëse. Nga auditimi u konstatua se jo vetëm për periudhën objekt auditimi (2021-2024), por edhe përtej kësaj periudhe (minimalisht që nga viti 2015), AKM nuk ka realizuar asnjëherë monitorime vjetore për Liqenin Artificial të Tiranës.

**2.1. Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masat për kryerjen e monitorimit në stacionin e përcaktuar në Liqenin Artificial të Tiranës, sipas treguesve mjedisorë, frekuencës dhe metodave të përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe të vendosë në dijeni Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkinë Tiranë për rezultatet e këtyre analizave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, pavarësisht se ka evidentuar dhe faktuar edhe nga rezultatet e analizave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, se në liqen shkarkohen ujëra të ndotura urbane të patrajtuara (që në muajin tetor 2024), përveç korrespondencave shkresore, nuk ka marrë asnjë masë konkrete për evidentimin e shkaktarëve të ndotjes, marrjen e masave ndaj tyre si dhe zgjidhjen e problematikës. Nga korrespondencat shkresore të iniciuara nga APR ka rezultuar se AKUK nuk kanë kthyer përgjigje, ndërsa UKT sh.a nuk është përgjigjur konkretisht kërkesave të adresuara nga APR. Pra, bashkëpunimi ndërinstytucional nuk ka funksionuar, komunikimet mes institucioneve janë kufizuar në korrespondencë zyrtare, duke ndikuar drejtpërdrejtë në zvarritjen e problematikës dhe moszgjidhjen e situatës.

**3.1 Rekomandimi:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, në rastet e mungesës së reagimit nga institucionet të cilave u është drejtuar për informacion apo bashkëpunim, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme institucionale për raportimin e problematikës në organet eprorë përkatëse, me qëllim garantimin e funksionimit efektiv të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe shmangien e pasojave negative për ndotjen e liqenit.

**Në vijimësi**

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

Ujërat e ndotura urbane të patrajtuara që vijnë nga zona e urbanizuar (Liqeni i Thatë dhe zona përreth Kopshtit Zoologjik) dhe shkarkohen në liqenin artificial të Tiranës, janë konfirmuar nga AKM dhe IKMT, duke evidentuar edhe pikat e shkarkimit, si dhe duke cilësuar se ndotja vjen nga përzierja e ujërave të bardha me ujërat e ndotura, në formën e rrjedhave të lira nga tobinat. Nga auditimi u konstatua se, mungesa e disponimit të një harte të rrjetit të kanalizimeve nga UKT-ja dhe institucionet e tjera të varësisë së Bashkisë Tiranë nuk ka mundësuar gjurmimin e burimit të ndotjes nga ana e institucioneve inspektuese. Këto institucione inspektuese edhe pse kanë evidentuar pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura

urbane, nuk kanë mundur të identifikojnë burimet e ndotjes në mungesë edhe të një harte të shtrirjes së këtyre kanalizimeve.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Tiranë dhe Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a të marrin masa të menjëhershme për krijimin e një harte, ku të pasqyrohet jo vetëm rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane (KUZ), por edhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha/ të shiut (KUB), me qëllim marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës në Liqenin Artificial të Tiranës, por edhe masave parandaluese për situata të tjera të ngjashme që mund të ndodhin në të ardhmen në qytetin e Tiranës.

**Brenda vitit 2025**

## **5. Gjetje nga auditimi:**

-Nga analizat e kryera nga AKM dhe interpretimi i tyre, ka rezultuar se në trupin ujor të Liqenit Artificial të Tiranës ka shkarkime të ujërave të ndotura urbane. APR ka përcaktuar disa pika shkarkimi të mundshme, në të cilat AKM ka vijuar me kryerjen e analizave përkatëse. Pas rezultatit të këtyre analizave AKM ia ka deleguar ARM Tiranës ndjekjen e hapave të mëtejshme për kryerjen e inspektimeve në terren. ARM Tirana ka iniciuar inspektimin dhe e ka përmbyllur duke arsyetuar se subjektet në territorin e PMLAT nuk kanë leje mjedisore dhe rrjedhimisht nuk janë objekt i inspektimit të saj. Pikat e evidentuara nga APR dhe AKM janë pikat shkarkimi të kanalizimeve të ujërave të bardha, që lidhen me pjesën e kodrave të Liqenit dhe “Liqenit të thatë”, rrjedhimisht këto shkarkime në pikat e identifikuar vijnë nëpërmjet rrjetit të kanalizimeve dhe nuk janë gjeneruar nga subjekte që operojnë në territorin e PMLAT. Për sa më sipër, grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi subjektet që janë identifikuar, për të cilat ARM ka konkluduar se nuk disponojnë leje mjedisore dhe nga AKM e ARM Tirana nuk është kthyer përgjigje.

Nga verifikimi i kryer në terren u evidentua se përpos shtatë pikave që janë identifikuar nga APR dhe marrë mostra për analizë nga AKM, grupi i auditimit evidentoi dhe 3 pika të tjera të kanaleve të ujërave të shiut që derdhen në liqen, të cilat ishin të dëmtuara, të bllokuara ose që kishin derdhje të ujërave të përdorura, në të cilat nuk rezultoi të jenë marrë mostra dhe të jenë kryer inspektime. Për sa më sipër, pavarësisht se kemi pasur të bëjmë me një situatë kritike mjedisore, inspektimi i kryer nga ARM Tirana nuk ka qenë i plotë, si dhe nga ana e institucioneve nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për identifikimin e ndotësve, për të vlerësuar nëse ka edhe subjekte që disponojnë leje mjedisore, për të vijuar më tej me marrjen e masave për eliminimin e shkarkimeve të ujërave të patrajtuar/ të ndotur (urbane/ industriale, etj.) drejtpërdrejt në liqen.

- Zona brenda Parkut të Madh të Liqenit Artificial nuk mbulohet nga rrjet kanalizimesh për ujërat e ndotura urbane. Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë nuk kanë asnjë informacion, si dhe nuk kanë kryer asnjë verifikim në terren, mbi metodat e trajtimit individual të ujërave të ndotura nga subjektet që operojnë brenda territorit të PMLAT.

Institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë (APR, UKT Sh.a, etj.) nuk kanë informacion mbi gropat septike të subjekteve që ndodhen në territorin e PMLAT, mbi vendndodhjen e tyre apo mbi menaxhimin/pastrimin e tyre, në mospërputhje me funksionet e bashkisë të përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 2 “Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe nuk ka një numër të saktë të subjekteve në këtë territor.

Grupi i auditimit gjithashtu ka konstatuar se Bashkia Tiranë nuk ka përmbushur detyrat e saj funksionale bazuar në Ligjin Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”, i ndryshuar pasi nuk ka bashkëpunuar me MTM-në me qëllim kontrollin e vazhdueshëm të

veprimtarive që shkarkojnë ndotje të ujërave si dhe subjektet që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre<sup>20</sup>.

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrin masa për ngritjen e një grupi ndërinstytucional, me përfaqësi nga institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë dhe institucione të qeverisjes qendrore sipas fushëveprimeve përkatëse, për:

1. Evidentimin e të gjitha pikave të shkarkimit të ujërave të përdorura/ të ndotura (urbane, industriale, etj.), duke përfshirë, por pa u kufizuar pikat e evidentuara nga grupi i auditimit, me qëllim:

- Ndjekjen e kanaleve të ujërave të shiut, për të evidentuar shkarkimet e jashtëligjshme të ujërave të përdorura në kanalet e ujërave të shiut;
- Ndërprerjen e menjëhershme të shkarkimeve të jashtëligjshme të ujërave të ndotura urbane në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha/ të shiut;
- Evidentimin e ndotësve dhe marrjen e masave administrative sipas përcaktimeve ligjore kundrejt tyre.

2. Evidentimin dhe vlerësimin e gjendjes së gropave septike të subjekteve brenda territorit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, për të garantuar operimin e tyre sipas standardeve dhe pa cënuar mjedisin.

## Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit nuk ka një strukturë në Drejtorinë e Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës (PMLAT), për të garantuar përmbushjen e funksioneve kontrolluese, inspektuese, evidentuese të veprimtarive të jashtëligjshme, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme. Si pasojë, nuk është evidentuar asnjë problematikë mjedisore ndër vite mbi shkaqe të mundshme të ndotjes së ujit të liqenit dhe nuk është kërkuar asnjëherë kryerja e analizave specifike për të evidentuar problematika përpara shfaqjes në sipërfaqe të ndotjes dhe marrjes së vëmendjes mediatike të problematikës së shfaqur.

**6.1. Rekomandimi:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa për riorganizimin e strukturës së Drejtorisë së Administrimit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, në përmbushje të funksioneve kontrolluese, inspektuese dhe evidentuese të veprimtarive të jashtëligjshme, të cilat lidhen ndër të tjera me Liqenin Artificial të Tiranës, bazuar në detyrimet e përcaktuara dhe në Rregulloren e Brendshme.

## Brenda vitit 2025

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren u konstatua një biomasë në sipërfaqen e liqenit, si dhe popullatë e shtuar e shpendëve, e cila vjen si rrjedhojë e ushqimit të bollshëm në liqen, konstatuar edhe nga raport analizat e AKM-së ku ka rezultuar përmbajtje në nivele të larta të fosfateve dhe nitrateve në këtë trup uJOR. Dukuria e daljes së peshqve në sipërfaqe, dokumentuar edhe nëpërmjet fotove nga verifikimi në terren, pasqyron mungesën e oksigjenit në këtë trup uJOR, konfirmuar edhe nga raport analizat e AKM-së, ku kanë rezultuar nivele të larta të nevojës kimike për oksigjen. Përmbajtja e lartë e nutrientëve dhe e ulët e oksigjenit tregon se në liqen ka shkarkime të shumta të substancave të pasura me azot dhe fosfor dhe të substancave reduktuese, të cilat konsumojnë oksigjenin. Gjithashtu, kur ka një akumulim të biomasës (bimësisë), pas “vdekjes” së bimëve ose algave, fillon procesi i dekompozimit, i cili kërkon oksigjen, duke çuar në një ulje të përmbajtjes së oksigjenit të tretur në ujë, veçanërisht në orët e errësirës kur fotosinteza ndalon dhe ndodh respiracioni. Kjo situatë mund të përkeqësohet nga temperaturat më të larta, ku përmbajtja e oksigjenit do të jetë më e vogël dhe

<sup>20</sup> Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003, i ndryshuar, Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, neni 4, pika 2, shkronja dh

gjendja mund të përkeqësohet, për shkak të rritjes së temperaturave dhe të zvogëlimit të vëllimit të ujërave.

#### **7.1 Rekomandimi:**

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa për të larguar biomasën e krijuar nga liqeni në sipërfaqe, në mënyrë që të mos ndodhë dekompozimi i saj në liqen dhe të shmanget konsumimi i oksigjenit nga algat dhe aromat e pakëndshme për shkak të këtij fenomeni.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Interpretimi i treguesve në analizat e kryera nga AKM-ja dhe inspektimet e kryera nga IKMT-ja në Liqenin artificial të Tiranës, kanë konstatuar shkarkimin e ujërave të përdorura urbane në të, duke shkaktuar ndotjen e këtij trupi ujor, konstatuar edhe nga raportet e analizave të AKM-së. Ekspertët e fushës cilësojnë se, për pasojë të sa më sipër, është shfaqur në liqen një lulëzim i Cianobakterit *Microcystis Aeruginosa*, duke këshilluar që të bëhet kujdes me peshkimin dhe çdo përdorim të ujit të këtij ekosistemi. Kur përmbajtja e fosforit total (P-PO<sub>4</sub>) është >0.03 mg/L, si në rastin e këtij trupi ujor, gjendja e ujit sipërfaqësor është *eutrofe*, duke sjellë zhvillimin masiv të algave mikroskopike (lulëzimi) në fitoplankton, shpesh cianobaktereve dhe jo rrallë të atyre që janë helmuese.

**8.1 Rekomandimi:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtoria e Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës të marrin masa për të lajmëruar popullatën mbi elementët ndotës që ndodhen në liqen dhe për të mos lejuar veprimtari që lidhen me përdorimin e ujërave të liqenit, si peshkimi tradicional apo ndonjë veprimtari tjetër brenda Liqenit, deri në zgjidhjen e situatës së shkaktuar nga ndotja.

**Menjëherë**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**